



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RAPORT

I

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

MBI GJËNDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2009

TIRANË 2010

HYRJE

Paraqitja e raportit vjetor “Mbi gjëndjen e Kriminalitetit për vitin 2009” bëhet me ftesën e Kuvendit të Shqipërisë në përmbushje të detyrimit të nenit 149 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 53 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar), ku parashikohet se, raportimi i Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend, duhet të përmbajë të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë si dhe drejtimit dhe përparësitë në luftën ndaj kriminalitetit.

Mekanizmi i akuzës është përgjegjës për të siguruar që ligji është zbatuar. Kur ligjet janë shkelur dhe krimet janë kryer, prokuroria duhet të sigurojë që është ndjekur procesi i duhur dhe që drejtësia është siguruar.

Nisur nga analiza e treguesve të veprimtarisë në të gjithë nivelet e prokurorisë, mund të themi se viti 2009 evidenton progres në rritje të organit të akuzës në ushtrimin e përgjegjësisë kushtetuese e ligjore.

Falë angazhimit të prokurorëve në drejtimit më kryesore të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre, në veprimtarinë e organit që drejtojnë, vihet re rritje e treguesve sasiorë dhe cilësorë të punës së organit të prokurorisë.

Interesi më i lartë i qënies njerëzore në botë është drejtësia. Ajo është ligamenti që mban qëniet e qytetëruara dhe kombet e qytetëruara së bashku.

Duke e konsideruar veten pjesë të kësaj bote, kemi synuar që krimin t’a trajtojmë dhe t’a kurojmë si një lloj sëmundje, duke patur në konsideratë edhe një fakt shumë të rëndësishëm se administrimi i drejtësisë penale është pilari më i parë dhe më i rëndësishëm i “qeverisjes” së një vendi.

Efienca dhe efektiviteti i punës së organit të prokurorisë ka qenë objektivi ynë për të kontribuar në atë që:

“Asgjë nuk duhet të preferohet përpara drejtësisë”!

VOLUMI I PUNËS SË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2009

Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Funksioni i prokurorit duhet të ushtrohet në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Prokuroria si organ i pavarur punën e saj e bazon në parimin e pavarësisë kundrejt të gjithë pjesëmarrësve në procedurë penale si dhe organeve të tjera shtetërore.

Organet e prokurorisë janë:

- a) Prokuroria e Përgjithshme e Republikës;
- b) Prokuroria pranë gjykatës së apelit për Krime të Rënda;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të Apelit;
- ç) Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda;
- d) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.

Gjatë vitit 2009, në organin e prokurorisë janë trajtuar njoftime për vepra penale të ndodhura dhe janë ndjekur penalisht 22 276 procedime penale, prej të cilave janë regjistruar në total 16 910 procedime penale; janë mbartur nga viti i kaluar 4 743 procedime penale dhe janë rifilluar 623 procedime, dhe është vendosur mosfillimi për 5 679 (në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda).


Gjatë vitit 2009, nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, është ngritur dhe është përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 6 622 procedime me 8 352 të pandehur. Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 7 547 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal për persona nën hetim.

Nga prokuroritë pranë gjykatave të Apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 2 982 çështje themeli dhe 1163 raste për masat e sigurimit personal.

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit pranë Gjykatës së Lartë për gjykime themeli, masa sigurimi personal, përfaqësime në Kolegjet e Bashkuara dhe, në cilësinë e subjektit të interesuar, në mbrojtje të interesave të shtetit dhe të individëve, pranë Gjykatës Kushtetuese, për 316 çështje.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Volumi i punes i organit te prokurorise 2009




Më poshtë paraqitet grafikisht volumi i punës së organit të prokurorisë për vitet 2008-2009:

Volumi i punes i organit te prokurorise 2008-2009




Më poshtë, paraqitet grafikisht volumi i punës së organit të prokurorisë për procedimet penale të regjistruara në pesë vitet e fundit (2004-2008):



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 vihet re një rritje e procedimeve penale të rregjistruara prej 5% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të rregjistrimit të procedimeve penale prej 11,2% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 8,7% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 2,54% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë, ulje kjo e ndikuar nga rritja 22,63% (për qind) e numrit të mosfillimit të procedimeve.

Rritja e volumit të punës së organit të prokurorisë vihet re edhe në procedimet penale që kanë qenë në ndjekje penale gjatë vitit 2005-2009.

Grafiku i mëposhtëm paraqet “ndjekjen penale” në pesë vitet e fundit (2005-2009):




Sikurse shihet edhe nga grafiku, procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë kanë ardhur gjithnjë në rritje. Kështu, në vitin 2006 vihet re një rritje të procedimeve në ndjekje penale me 5,5% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve në ndjekje penale me 9,7% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje

prej 7,95% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një rritje prej 4,69% (për qind) të procedimeve në ndjekje penale pranë organit të prokurorisë.

MBI PROCEDIMET E HETUARA DHE TË PËRFUNDUARA

Nga shqyrtimi i të dhënave statistikore për pesë vitet e fundit (2005–2009), lidhur me çështjet për të cilat është përfunduar hetimi nga organi i prokurorisë, rezultojnë se:




Sikurse vihet re edhe nga grafiku, në lidhje me çështjet e përfunduara, në vitin 2006 ka rritje të këtyre çështjeve prej 6,32% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 9,32% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka përsëri rritje prej 1,34% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri rritje prej 7,95% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me çështjet e pezulluara, në vitin 2006 ka ulje të këtyre çështjeve prej 3,26% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 14,35% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka përsëri rritje prej 7,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri rritje prej 27% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me çështjet e pushuara, në vitin 2006 ka rritje të këtyre çështjeve prej 17,3% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 9,55% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 12,53% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri rritje prej 9,8% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me çështjet e dërguara në gjyq, në vitin 2006 ka rritje të këtyrë çështjeve prej 5,33% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 6% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 7,68% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje prej 5,84% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake.




Siç shihet edhe nga tabela, rezulton se numri i të pandehurve të dërguar në gjyq për vitin 2006 ka rritje prej 7,03% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri rritje të procedimeve të dërguara në gjyq prej 2,52% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 13% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje prej 4,28% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehur të pushuar dinamika në pesë vitet e fundit është e tillë që: në vitin 2006 ka rritje prej 21,77% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri rritje prej 39,39% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 20,48% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka rritje prej 3,8% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe respektivisht kërkimet e prokurorit për pafajësi dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë, në pesë vite 2005-2009.

Në lidhje me vendimet e gjykatës për pafajësinë, rezulton nga të dhënat statistikore se: në vitin 2006 ka ulje prej 21,33% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje prej 1,12% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 6,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 vihet re rritje prej 29,56% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e më poshtëm:



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2005, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 3,19% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate; në vitin 2006 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,35% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate; në vitin 2007, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,26% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate; në vitin 2008, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,13% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate dhe në vitin 2009, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,88% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate.

Në lidhje me kërkimin e prokurorit për pafajësi: në vitin 2006 vihet re rritje prej 28,57% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të theksuar prej 44,44% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka përsëri rritje prej 80% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 vihet re ulje prej 66,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me mënyrën se si kanë përfunduar çështjet e dërguara nga organi i prokurorisë në vendimet e gjykatës theksojmë se për pushimin e çështjes: në vitin 2006 vihet re rritje prej 3,39% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të theksuar prej 3 herë në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 77,3% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 vihet re rritje prej 25,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

MOSFILLIMET

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte e në rrugë të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 e vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementet e veprave penale, prandaj me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit që në këto raste të vendosë mosfillimin e procedimit penal.


Ky tregues i punës, i parë edhe si mjet për të evituar hetimet e panevojshme mbi bazën e kallëzimeve të papazuara, ka pësuar rritje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar.

Kështu, ndërsa në vitin 2008 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 4631 kallëzime, në vitin 2009 janë marrë 5679 vendime te tilla.

Natyrisht, të dhënat statistikore në drejtim të numrit të mosfillimeve nuk janë gjithcka nëse ato nuk janë të bazuara në ligj e në prova. Gjithësesi, mosfillimet e bazuara në ligj e në prova përbëjnë një tregues që parandalon hetime të panevojshme dhe krijon mundësinë për përqëndrimin e forcave të punës në çështje të rëndësishme.

Grafiku i mëposhtëm paraqet dinamikën e këtij treguesi në pesë vitet e fundit (2005-2009):

Në lidhje me mosfillimet, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka rritje prej 26,87% për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 vihet re rritje prej 19% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 vihet re rritje prej 13,64% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 vihet re përsëri rritje prej 22,63% (për qind) e vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në krahasim me vitin 2008.




PROCEDIME PENALE TË RREGJISTRUARA SIPAS RRETHEVE DHE KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT

Rezultojnë nga të dhënat statistikore se në Berat gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 498 procedime penale, që do të thotë rritje prej 6,41% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Dibër, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 318 procedime penale, që do të thotë ulje prej 14,74% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Durrës, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 1681 procedime penale, që do të thotë rritje prej 0,29% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Elbasan, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 1284 procedime penale, që do të thotë rritje prej 0,62% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Fier, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 817 procedime penale, që do të thotë rritje prej 1,36% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Gjirokastrë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 635 procedime penale, që do të thotë ulje prej 7,43% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Kavajë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 307 procedime penale, që do të thotë ulje prej 12,78% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Korçë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 1015 procedime penale, që do të thotë ulje prej 11,73% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Krujë gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 313 procedime penale, që do të thotë rritje prej 2,62% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Kukës, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 339 procedime penale, që do të thotë ulje prej 28,63% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Kurbin, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 301 procedime penale, që do të thotë


ulje prej 9,33% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Lezhë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 47 procedime penale, që do të thotë ulje prej 5,73% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Lushnje, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 456 procedime penale, që do të thotë rritje prej 10,67% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Mat, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 143 procedime penale, që do të thotë ulje prej 30,24% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Pogradec, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 277 procedime penale, që do të thotë ulje prej 23,48% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Pukë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 99 procedime penale, që do të thotë ulje prej 31,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Sarandë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 440 procedime penale, që do të thotë ulje prej 10,38% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Shkodër, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 966 procedime penale, që do të thotë ulje prej 15,18% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Tiranë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 4871 procedime penale, që do të thotë rritje prej 7,38% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Tropojë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 76 procedime penale, që do të thotë ulje prej 30,9% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Vlorë, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 1504 procedime penale, që do të thotë rritje prej 3,86% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Prokurorinë për Krime të Rënda, gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 93 procedime penale, që do të thotë ulje prej 7% (për qind) në krahasim me vitin 2008;

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike sipas procedimeve te rregjistruara gjatë vitit 2009 në rrethe të ndryshme të vendit dhe përqindjet përkatëse:

Shpërndarja gjeografike 2009




Në lidhje me koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë, në bazë edhe të procedimeve të rregjistruara për çdo rreth gjatë viteve 2008 dhe 2009 situata rezulton si më poshtë:

Në Vlorë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 1654.23 krime, ndërsa në vitin 2009 është 994.3276; Në Kukës, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 814,45 krime, ndërsa në vitin 2009 është 537.92; Në Sarandë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 803,365 krime, ndërsa në vitin 2009 është 728.03; në Durrës, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 680.19 krime, ndërsa në vitin 2009 është 692.59; Në Gjirokastrë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 666 krime, ndërsa në vitin 2009 është 619,44; në Tropojë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 631.24 krime, ndërsa në vitin 2009 është 467.57; në Tiranë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 624.32 krime, ndërsa në vitin 2009 është 679.2; në Korçë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 608.72 krime, ndërsa në vitin 2009 është 534.4; Në Kurbin, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 599.57 krime, ndërsa në vitin 2009 është 547.7; në Pukë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 578.94 krime, ndërsa në vitin 2009 është 407.17; në Shkodër, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 505.97 krime, ndërsa në vitin 2009 është 435.81; në Pogradec, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 502.99 krime, ndërsa në vitin 2009 është 392.63; në Lezhë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 480,17 krime, ndërsa në vitin 2009 është 459; në Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 445.5 krime, ndërsa në vitin 2009 është 462.51; në Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 415.86 krime, ndërsa në vitin 2009 është 293.12; në Kavajë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 414.89 krime, ndërsa në vitin 2009 është 370.37; në Dibër, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 396.61


krime, ndërsa në vitin 2009 është 337.49; në Elbasan, koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 365 krime, ndërsa në vitin 2009 është 374.35; Në Fier, koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 344.77 krime, ndërsa në vitin 2009 është 354.12; në Lushnjë, koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 283.26 krime, ndërsa në vitin 2009 është 318.38; në Berat, koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 270.99 krime, ndërsa në vitin 2009 është 291.59.

Grafiku i mëposhtëm paraqet koefiçientin e kriminalitetit për 100.000 banorë sipas rretheve të vendit për vitin 2009:



Sikurse vihet re edhe nga grafiku rrethet të cilët kanë problematikë më të lartë në lidhje me kriminalitetin janë rrethet e Vlorës, Sarandës, Durrësit, Tiranës, Gjirokastrës, Kurbin etj.

Më poshtë paraqiten grafikisht, koefiçientët e kriminalitetit sipas rretheve në vitet 2008-2009:



Për Prokurorinë pranë gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton nga të dhënat statistikore se gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 93 procedime penale, që do të thotë ulje prej 7% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Në lidhje me koeficientin e kriminalitetit për 100.000 banorë, për grupin e veprave penale që shqyrton kjo prokurori rezulton se, koeficienti

i kriminalitetit për vitin 2008 ishte 3,15 dhe në vitin 2009 është bërë 2,91. Ulja e koeficientit të kriminalitetit për këtë grupim është shumë e rëndësishme.

KOEFICIENËT E KRIMINALITETIT

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2009 është 529.45, është në ulje në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2008 ishte 547.37.

Koeficientët e kriminalitetit sipas strukturës së Kodit Penal.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se:

Për Seksionin e Parë, Kreu i Tretë i Kodit Penal, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 184.9, “Vjedhja e Pasurisë”.

Për Seksionin e Tretë, Kreu i Tetë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 101.94 “Vepra penale kundër rendit dhe Sigurisë Publike”

Për Seksionin e Tetë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 37.66 “Falsifikimi i Dokumenteve”.

Për Seksionin e Tretë, Kreu i Dytë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 25.86 “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit”.

Për Seksionin e Tretë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 24.48 “Shkatërrimi i Pronës”.

Për Seksionin e Tretë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 20.25 “Krimet Kundër jetës të Kryera me Dashje”.

Për Seksionin e Dytë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 19.72 “Mashtrimet”.

Për Seksionin e Parë, Kreu i Tetë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 17 “Krimet Kundër Autoritetit të Shtetit”.

Për Seksionin e Dytë, Kreu i Tetë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 16,62 “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetëror ose në Shërbim Publik”.

Për Seksionin e Pestë, Kreu i Dytë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 7.54 “Vepra Penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës”.

Për Seksionin e Pestë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 7.42 “Krimet në fushën e Doganave”.

Për Seksionin e Dhjetë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 5.82 “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”.

Për Seksionin e Njëmbëdhjetë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 5.44 “Vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës”.

Për Seksionin e katërt, Kreu i Tetë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 4.6 “Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë”.

Për Seksionin e tetë, Kreu i Dytë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 3.19 “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”.

Për Seksionin e Shtatë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 3.13 “Vepra penale kundër lirisë së përsosur”.

Për Seksionin e Gjashtë, Kreu i Tretë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 3, “Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet”.

Për Seksionin e Shtatë, Kreu i Tretë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 2.84 “Falsifikimi i monedhave dhe i letrave me vlerë”.

Për Seksionin e Gjashtë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 2.25 “Krime seksuale”.

Për Seksionin e Nëntë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 1.22 “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”.

Për Seksionin e Dytë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 0.59 “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”.


Për Seksionin e Katërt, Kreu i Tretë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 0.4 “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare”.

Për Seksionin e Katërt, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 0.21 “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia”.

Për Seksionin e Dhjetë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 0.09 “Vepra penale kundër lirisë së besimit”.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Koeficientet e kriminalitetit sipas struktures se Kodit Penal



TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT PËR VITIN 2009.

Aspekt i punës së organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale.


Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre.

Kështu, gjatë vitit 2009, prokurorët kanë urdhëruar ekzekutimin e 6481 vendimeve penale të formës së prerë. Nga këto vendime, janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 2883 vendime penale të formës së prerë ose duke u krahasuar me vitin 2008 ka një ulje prej 12,47% (për qind) të këtij treguesi.

Vendime të cilët kanë mbetur pa u ekzekutuar (ku përfshihen edhe vendimet e mbartura të paekzekutuara), gjatë vitit 2009 janë 7249, duke u krahasuar me vitin 2008, ka një rritje prej 46% (për qind).

Në lidhje me këtë tregues rezulton se gjatë vitit 2009 kanë mbetur pa u ekzekutuar 24 vendime për masën e dënimit burgim i përjetshëm, përkundrejt 21 vendime me burgim të përjetshëm të paekzekutuara gjatë vitit 2008; 2107 vendime me burgim gjatë vitit 2009 përkundrejt 1454 të tilla në vitin 2008; 4266 vendime për dënimin me gjobë përkundrejt 3034 të tilla në vitin 2008 dhe 852 dënime plotësuese në vitin 2009, përkundrejt 456 të tilla në vitin 2008.

Grafik:



TË DHËNA NË LIDHJE ME REFERIMET

Në vitin 2009 janë bërë në total 21075 referime, përkundrejt vitit 2008 kur janë bërë 21411 referime, që do të thotë se kemi një ulje të lehtë prej 1,56% (për qind) gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008.

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2009 janë filluar kryesisht nga prokuroria 264 procedime. Në këtë shifër nuk përfshihet ngritja e akuzave të reja nga prokurorët përtej fakteve kriminale të referuar në materialin kallëzues dhe të evidentuara gjatë hetimeve të kryera.

Kallëzime nga nëpunësit publikë, gjatë vitit 2009 rezultojnë 905 dhe për vitin 2008 rezultojnë 1202 kallëzime, që do të thotë ulje prej 24,7% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Kallëzime nga personeli mjekësor, gjatë vitit 2009 rezulton 1 kallëzim dhe për vitin 2008 rezultojnë 5 kallëzime.

Kallëzime nga shtetasit, në vitin 2009 rezultojnë 2358 kallëzime ndërsa në vitin 2008 rezultojnë 2405 kallëzime, që do të thotë ulje prej 1,95% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Ankime për vepra penale që ndiqen mbi ankime rezultojnë 210 ankime në vitin 2009 dhe 103 të tilla në vitin 2008, që do të thotë 2 herë më shumë në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2009 është marrë njoftim për 2560 ngjarje, përkundrejt vitit 2008 kur kanë qenë 2106 ngjarje, që do të thotë se është një tregues në rritje prej 21,55% (për qind) në vitin 2009

në krahasim me vitin 2008.

Gjithashtu, theksojmë se gjatë vitit 2009 janë marrë 14337 kallëzime nga policia e shtetit, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 14529 kallëzime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re ulje e tyre gjatë vitit 2009 prej 1,32% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2009 janë marrë 70 kallëzime nga policia financiare, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 32 kallëzime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re rritje e tyre gjatë vitit 2009 prej 2,18 herë në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2009 janë bërë 194 kallëzime nga policia pyjore, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 188 kallëzime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re rritje e tyre gjatë vitit 2009 prej 3,19% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2009 janë bërë 106 kallëzime nga policia elektrike, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 391 kallëzime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re ulje e ndjeshme e tyre gjatë vitit 2009 prej 72,89% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjithashtu janë bërë 42 kallëzime pranë organit të prokurorisë edhe nga “polici të tjera” gjatë vitit 2009 dhe rreth 62 kallëzime gjatë vitit 2008.

VEPRAT PENALE KUNDËR PËRSONIT, KRIME KUNDËR JETËS

KREU II

SEKSIONI I

“KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE”

Ne Seksionin e Parë, Kreu i Dytë i Kodit Penal parashikohen Krimet Kundër Jetës të Kryera me Dashje.

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 26.26 ndërsa për vitin 2009 është 20. Është e qartë tendenca për ulje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 4% (për qind) për vitin 2008 dhe 3.8% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Parë, Kreu i Dytë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet Kundër Jetës të Kryera me Dashje.

VP kunder Përsonit	2008					2009				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja	251	125	133	143	97	<u>192</u>	111	115	118	111
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	1	0	0	0	2	0	0	0	0	0

Neni 78 Vrasja me paramendim	77	38	52	49	68	83	45	66	53	61
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	<u>31</u>	25	27	33	29	<u>52</u>	26	25	34	25
Neni 81 Vrasja e foshnjës	<u>3</u>	0	0	0	0	<u>1</u>	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	5	8	5	10	7	3	2	3	2	3
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme	<u>1</u>	2	1	2	1	<u>5</u>	1	4	1	1
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje	1	1	1	1	0	1	1	2	2	3
Neni 84 Kanosja	<u>391</u>	152	236	180	165	331	153	187	171	149
Totali	761	351	455	418	369	641	339	402	381	353

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2009 ka një ulje prej 15.8 % (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për krime kundër personit në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq kemi ulje prej 3,4 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2008. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të rregjistruar përkundrejt këtj totali në vitin 2008 prej 11,6 % (për qind) dhe një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 8,8 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 4,3 % (për qind) përkundrejt vitit 2008.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 579 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 664 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 13,4% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Në të dy vitet, në përqindje, shifra është e njëjtë në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë dhe është 67% (për qind) në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim.

Nga të pandehurit, 27 kanë qenë te pandehur të mitur meshkuj dhe 1 femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 16 femra dhe 440 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezulton rritje e të pandehurve femra në vitin 2009. kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve femra ka qenë 8 ndërsa në vitin 2009 rezulton të jetë 16, pra është rritur 2 herë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 358 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 126 me arsim të mesëm dhe 7 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bejnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë rregjistruar 2 të pandehur (që do të thotë ulje prej 81,81% (për qind) në krahasim me vitin 2008). Nga këta, 1 i pandehur është funksionar, dhe 1 i pandehur është

nëpunës i thjeshtë. Nga sektori privat janë rregjistruar 86 të pandehur (rritje prej 6,17% për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe të papunë 326 (ulje prej 4,67% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Të papunë rezultojnë të jenë 326 të pandehur, që do të thotë ulje prej 4,67% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Nga të punësuarit, 86 të pandehur të punësuar nga sektori privat dhe 2 të pandehur nga sektori shtetëror. Vihet re ulje e ndjeshme e të pandehurve nga sektori shtetëror në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 ku rezultojnë 11 të pandehur nga sektori shtetëror.

Rezulton se 284 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 193 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 449 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 23 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 8 meshkuj të mitur (mosha 14-18 vjeç) dhe gjithsej 177 meshkuj madhorë, ndërsa 21 janë femra.


Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 171 vdekje, 63 plagosje e rëndë dhe 26 plagosje e lehtë. Në krahasim me vitin 2008 rezulton ulje e pasojës “plagosje e lehtë” dhe përsëri me ulje, me pasojë vdekjen nga 208 raste në vitin 2008 në 171 raste në vitin 2009.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me Dashje”, në vitin 2009, prej 23,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”, për 100 000 banorë në vitin 2009 është 6, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 7.9 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë).




Duke interpretuar grafikun e mësipërm, në vitin 2006 duke u krahasuar me vitin 2005 kemi një tendencë në ulje të kriminalitetit që lidhet me këtë vepër penale prej 23,2% (për qind). Ne

vitin 2007 ka përsëri një tendencë në rënie të këtij kriminaliteti prej 3,5% krahasuar me vitin 2006; në vitin 2008 vihet re një tendencë në ulje në masën 8,4% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 vihet re përsëri ulje e procedimeve të rregjistruara pranë organit të prokurorisë prej 23,5% (për qind).

Shpërndarja gjeografike e kësaj vepre penale është e tillë që Tirana ka peshën specifike më të madhe përkundrejt totalit të kësaj vepre penale të procedimeve të rregjistruara në shkallë Republike, zë 18% (për qind), Durrës 13% (për qind), Korçë 9% (për qind) Shkodër 8% (për qind), Vlorë, Kurbin dhe Dibër përkatësisht 6% (për qind), Fier dhe Elbasan 5% (për qind), Sarandë dhe Krujë përkatësisht 4% (për qind).

Neni 76 "Vrasja me Dashje"
Viti 2009



Në rubrikën “Të tjerë” janë përfshirë rrethe të cilët kanë rregjistruar përkatësisht: Kavaje 2 procedime, Kukës 3 procedime, Pogradec 3 procedime, Berat 4 procedime, Mat 4 procedime, Gjirokastrë, Lezhë dhe Lushnje nga 5 procedime, për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me Dashje”.


Sikurse vihet re edhe nga grafiku, rrethet Tiranë, Durrës dhe Korçë janë rrethet ku është edhe e pranishme më shumë në të dy vitet 2008-2009 “Vrasja me dashje”.

Vihet re se për rrethin e Pogradecit ka një tendencë në ulje të theksuar në vitin 2009. Kështu, nga 17 procedime penale për këtë vepër penale në vitin 2008, në vitin 2009 rezulton në ulje me vetëm 3 procedime penale të rregjistruara për nenin 76 të Kodit Penal “Vrasja me Dashje”. Në rrethin e Beratit, në vitin 2008 janë rregjistruar 13 procedime penale ndërsa në vitin 2009 janë rregjistruar vetëm 4 procedime penale për këtë vepër penale. Rrethi i Gjirokastrës, 14 procedime penale janë rregjistruar për këtë vepër penale në vitin 2008 dhe vetëm 5 të tilla në vitin 2009. Gjithashtu, me tendencë në ulje paraqitet edhe rrethi i Korçës. Kështu, në këtë rreth janë rregjistruar 18 procedime penale për këtë vepër penale në vitin 2009 dhe në vitin 2008, 24 procedime penale. Rrethet, Lezhë dhe Lushnje kanë rregjistruar nga 11 procedime penale në vitin 2008 dhe vetëm 5 në vitin 2009.

Në rrethin e Kurbinut vihet re një tendencë në rritje për vitin 2009. Kështu, në këtë rreth janë rregjistruar 11 procedime penale dhe në vitin 2008 ka rregjistruar vetëm 1 procedim penal për këtë vepër penale. Rrethi i Tiranës, rezulton me 35 procedime penale të rregjistruara në vitin 2008 dhe me 45 procedime penale në vitin 2009.

Më poshtë paraqiten grafikisht procedimet penale të rregjistruara sipas rretheve për veprën penale “Vrasja me dashje” të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, për vitet 2008-2009:

Neni 76 "Vrasja me dashje" 2008-2009




NENI 78, "VRASJA ME PARAMENDIM", I KODIT PENAL

Vihet re tendenca në rritje e procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal "Vrasja me paramendim". Kjo tendencë rezulton të jetë në rritje me 7,79% (për qind) më shumë në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal "Vrasja me paramendim", për 100.000 banorë në vitin 2009 është 2,59 ndërsa për vitin 2008 ka qenë 2,4 krime për 100.000 banorë.

Tendenca e kësaj vepre penale në vitet e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në interpretim të grafikut të mësipërm, theksojmë se në vitin 2005 duke u krahasuar me vitin 2004 kemi një tendencë në ulje të kriminalitetit që lidhet me këtë veprë penale prej 12,35% (për qind); në vitin 2006 ka përsëri një tendencë në rënie të këtij kriminaliteti prej 16,7% (për qind) krahasuar me vitin 2005; në vitin 2008 vihet re një tendencë në rritje në masën 18,46% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri një tendencë në rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në masën 7,79% (për qind).

Neni 78 Vrasja me Paramendim, paragrafi i parë, nga të dhënat statistikore rezultojnë gjithsej 70 procedime penale të rregjistruara për vitin 2009. Po kjo veprë penale e kryer:

- për interes 2-procedime penale të rregjistruara në vitin 2008 dhe 5 procedime penale të rregjistruara në vitin 2009;
- për hakmarrje 4- procedime penale të rregjistruara në vitin 2008 dhe 7 procedime penale të rregjistruara në vitin 2009;
- për gjakmarrje 3- procedime penale të rregjistruara në vitin 2008 dhe 1 procedim penal të rregjistruar në vitin 2009.

Sikurse vihet re, vrasjet me paramendim për interes dhe për hakmarrje zënë peshën specifike më të madhe, brenda paragrafit të dytë të nenit 78 ndërsa rezultojnë me ulje vrasja me paramendim për gjakmarrje.

Vrasja me paramendim për interes (pesha specifike) zinte 2,6 (për qind) përkundrejt totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në vitin 2008 ndërsa në vitin 2009 pesha specifike e saj është 6% (për qind). Rezultojnë që gjeografikisht të jetë e pranishme në rrethet Berat 1, Kukës, Lezhë, Mat dhe Tiranë me nga 1 procedim penal të rregjistruar.

Vrasja me paramendim për hakmarrje (pesha specifike) zinte 5,2 për qind përkundrejt totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në vitin 2008, ndërsa në vitin 2009 pesha specifike është 8,4. Rezultojnë që gjeografikisht të jetë e pranishme në rrethet Durrës, 1 procedim penal, 1 procedim penal në Kukës, 1 procedim penal në Kurbin dhe në Shkodër 4 procedime penale.

Vrasja me paramendim për gjakmarrje zinte në vitin 3,9 për qind përkundrejt totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale, ndërsa në vitin 2009 pesha specifike e saj është 1,2. Rezultojnë e pranishme në rrethin Kukës 1 procedim penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim”, theksojmë se përgjithësisht është e pranishme në të gjithë territorin e vendit. Më poshtë paraqesim shpërndarjen e kësaj vepre penale duke krahasuar vitet 2008 dhe 2009.

Kështu, nga të dhënat statistikore rezultojnë se:


Berat ka një rritje prej 50% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në Dibër, në Gjirokastrë, në Pogradec, në Sarandë në të dy vitet është rregjistruar vetëm 1 procedim penal; në Durrës ka një rritje prej 16,7% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në Fier ka një rritje prej 33,3% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në Fier, në Kavajë, në Mat në vitin 2009 është rregjistruar vetëm 1 procedim penal, ndërkohë në vitin 2008 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal; në Krujë ka një rritje prej 100% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në Kukës ka një rritje prej 33,3% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në Kurbin ka një rritje prej 300% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në Lezhë ka një rritje prej 37,5% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në Lushnjë ka një rritje prej 200% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në Vlorë ka një rritje prej 133,3 % (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Në Elbasan ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 42,8% (për qind), në krahasim me vitin 2008; në Korçë ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Shkodër ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 43,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Tiranë ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Tropojë ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 66,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në Pukë nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale si në vitin 2008 ashtu edhe në vitin 2009.


Të dhënat e mësipërme paraqiten grafikisht në tabelën e mëposhtme:

**Shpërndarja Gjeografike neni 78 "Vrasja me paramendim"
viti 2009**



Në grafikun e mësipërm, në nënndarjen “Të tjerë” janë përfshirë rrethe që kanë regjistruar vetëm nga 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal, “Vrasja me paramendim” në vitin 2009.

Më poshtë paraqitet grafiksht shpërndarja gjeografike për veprën penale “Vrasja me paramendim” të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal.




NENI 79 I KODIT PENAL "VRASJA NË RRETHANA TË TJERA CILËSUESE"

Në këtë grup veprash penale vihet re tendencë në rritje e procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" në vitin 2009 prej 67,74% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal "Vrasja rrethana të tjera cilësuese", në vitin 2009 është 1,62 ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,97 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në vitet e fundit (2004-2009) paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë).



Në interpretim të grafikut të mësipërm, themi se në vitin 2005 duke u krahasuar me vitin 2004 kemi një tendencë në ulje të kriminalitetit që lidhet me këtë vepër penale prej 11.11% (për qind). Në vitin 2006 ka përsëri një tendencë në rënie të këtij kriminaliteti prej 18.75% (për qind) krahasuar me vitin 2005, në vitin 2007 tendenca në rënie është edhe më e thelluar në një masë prej 30.76% (për qind) krahasuar me vitin 2006. Në vitin 2008 vihet re tendenca në rritje në masën 14.81% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri tendencë në rritje të theksuar prej 67,7 % (për qind).

Shperndarja gjeografike neni 79 "Vrasja ne rrethana te tjera cilesuese"



Sikurse vihet re edhe nga grafiku, vepra penale e parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" është më shumë e pranishme në rrethet Durrës me 40 për qind të totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, Vlorë zë 30% (për qind), rrethet e Tiranës dhe Shkodër me nga 9% (për qind) dhe rrethet Fier, Lushnje, dhe Mat me nga 4 % (për qind). Rrethet e tjerë të cilët nuk janë përfshirë në këtë grafik nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale.

Gjithashtu, në Vlorë janë rregjistruar 7 procedime penale në vitin 2009 kohë në të cilën në vitin 2008 kanë qenë rregjistruar vetëm 2 procedime penale.

Nga të dhënat statistikore rezulton se ky fenomen ka ardhur me një tendencë të fortë në ulje për rrethin e Durrësit, rreth në të cilin rezulton se në vitin 2009 të jenë rregjistruar vetëm 3 procedime penale për këtë vepër penale ndërsa në vitin 2008 në po këtë rreth kanë qenë rregjistruar 9 procedime penale.

Me ulje të këtij fenomeni paraqiten edhe rrethet e Tiranës dhe të Elbasanit ku janë rregjistruar përkatësisht 2 procedime penale në vitin 2009 kur në vitin 2008 janë rregjistruar 5 të tillë. Në Elbasan, janë rregjistruar 4 procedime penale në vitin 2008 dhe nuk është rregjistruar asnjë procedim penal në vitin 2009.


Nga të dhënat statistikore vihet re një përqëndrim më i madh i këtij fenomeni në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 në rrethet kryesore në vend. Kështu, ndërsa në vitin 2009 janë vetëm pak rrethe në vend që kanë rregjistruar procedime penale për këtë vepër penale si, Fier, Lushnje, Mat, Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Durrës, në vitin 2008 kemi pothuajse 2 fishin e rretheve të cilët kanë rregjistruar procedime penale për këtë vepër penale, si Berat, Fier, Gjirokastrë, Krujë, Lezhë, Tropojë, Pogradec, Vlorë, Durrës, Kurbin, Lushnje, Shkodër, Elbasan dhe Tiranë.

NENI 84 I KODIT PENAL “KANOSJA”

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja” në vitin 2009 prej 15,34% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Gjithashtu, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të rregjistruar prej 20,8% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008, ulje e numrit të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 5 % (për qind) dhe përsëri me ulje numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata prej 9,7 për qind në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”, për 100.000 banorë në vitin 2009 është 10,36 ndërsa për vitin 2008 ka qenë 12,33 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në vitet e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Duke interpretuar grafikun e mësipërm rezulton se në vitin 2005 duke u krahasuar me vitin 2004 kemi një tendencë në rritje të kriminalitetit që lidhet me këtë vepër penale prej 12,98% (për qind). Në vitin 2006 ka përsëri një tendencë në rritje të këtij kriminaliteti prej 9,42% (për qind) krahasuar me vitin 2005, në vitin 2007 tendenca në rënie në masën prej 5.25% (për qind) krahasuar me vitin 2006. Në vitin 2008 vihet re tendenca në ulje në masën 13.3% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri tendencë në ulje të theksuar prej 15.34% (për qind).

Në lidhje me shërndarjen gjeografike, për këtë vepër penale, theksojmë se praktikisht është e pranishme në të gjithë territorin e vendit. Më poshtë paraqesim shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale në rrethe të ndryshme të vendit, të krahasuar në dy vite, përkatësisht 2008 dhe 2009.

Kështu, me rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale rezultojnë rrethet e mëposhtëm:

- Berati, ka një rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 110% (për qind) në krahasim me vitin 2008;
- Dibër, rezulton me rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2008;
- Kukës, rezulton me rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 21,4% (për qind) në krahasim me vitin 2008;
- Kurbin, rezulton me rritje të theksuar të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 350% (për qind) në krahasim me vitin 2008;
- Tiranë, rezulton me rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 6,2% (për qind) në krahasim me vitin 2008;
- Lushnje, rezulton me rritje të theksuar procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 116,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Me ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale rezultojnë rrethet e mëposhtëm

Në lidhje me të pandehurit rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 5,95% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë me ulje të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 13,43% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe rrezultojnë me rritje të pandehurit e dënuar nga gjykata prej 57% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 106 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 104 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 1,92% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezultojnë se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 58, që do të thotë ulje prej 12,12% (për qind) në krahasim me vitin 2008 (66 të pandehur). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 54,71% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 63,46% (për qind).

Nga të pandehurit në total, të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 76 meshkuj dhe 11 femra.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezultojnë ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 78 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 76 të pandehur meshkuj, pra rezultojnë me ulje prej 2,56% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezultojnë 11 të pandehura femra në vitin 2009 përkundrejt vitit 2008 kur është rregjistruar 1 e pandehur femër, pra me rritje prej 10 herë në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 38 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009 përkundrejt 58 të tillëve në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje prej 34,48% për qind, në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 45 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrejt 25 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me rritje prej 80% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 4 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të lartë për këtë grup veprash penale, përkundrejt 1 të pandehuri me arsim të lartë gjatë vitit 2008 të rregjistruar për këtë grup veprash penale.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 28 të pandehur që do të thotë se ky tregues rezulton me rritje prej 12% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; të papunë rezultojnë nga të dhënat statistikore 47 të pandehur, që do të thotë ulje prej 14,54% (për qind) e këtij treguesi në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Nga sektori shtetëror rezultojnë 11 të pandehur në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 1000% (për qind) në krahasim me vitin 2008; 2 të opandehur rezultojnë të jenë nëpunës të nivelit të lartë gjatë vitit 2009; 6 të pandehur rezultojnë të jenë nëpunës të nivelit të ulët dhe 3 të pandehur rezultojnë të jenë nëpunës të thjeshtë gjatë vitit 2009, përkundrejt vitit 2008 kur nuk është rregjistruar asnjë i pandehur në këtë kategori.

Rezulton se 41 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë rritje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 2,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 46 prej tyre në komuna, që do të thotë një rritje të të pandehurve me vendbanim në komunë për këtë grup veprash penale në vitin 2009 prej 6,97% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë (84 të pandehur, që do të thotë rritje prej 12% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi. Me rritje paraqitet gjendja gjyqësore e të pandehurve “përsëritës për vera penale të ndryshme” dhe rritja rezulton të jetë në vitin 2009 më 2 të pandehur në vitin 2009 përkundrejt 1 të pandehuri më këtë gjëndje gjyqësore në vitin 2008. Në të njëjtat nivele paraqitet gjendja gjyqësore e të pandehurve “përsëritës për të njëjtën vepër penale” nga 1 të pandehur me këtë gjëndje gjyqësore në vitin 2009 dhe në vitin 2008.

Të dëmtuar-viktima, për këtë grup veprash penale rezultojnë gjatë vitit 2009 në total 9 përsone. Nga këta, 2 femra (rritje prej 100% në krahasim me vitin 2008) dhe 7 meshkuj (rritje me 16,66% në krahasim me vitin 2008).

Në lidhje me pasojat në dëm të shëndetit, gjatë vitit 2009 rezulton nga të dhënat statistikore 1 rast “plagosje e lehtë”.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale rezultojnë me tendencë veprat penale të parashikuara nga nenet:

- neni 109 “Rrëmbimi ose mbajtja peng e përsoneit”;
- neni 109/b”Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”;
- neni 110 “Heqja e paligjshme e lirisë”.


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal “Rrëmbimi ose mbajtja peng e përsoneit” në vitin 2009 prej 52,63% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 109 “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, për 100.000 banorë në vitin 2009 është 0,28, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,59 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 17,59% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 9% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re rritje e numrit të procedimeve për gjykim në vitin 2009 prej 80% (për qind) në krahasim me vitin 2008; vihet re rritje e të pandehurve të rregjistruar prej 16,66% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me ulje rezultojnë të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 28,57% (për qind) dhe rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009 prej 66,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 3,7% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri ulje të procedimeve penale të rregjistruara prej 38,46% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 18,75% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit” prej 52,63% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale, vihet re se 4 procedime penale janë rregjistruar në Prokurorinë për Krime të Rënda, 2 procedime penale janë rregjistruar në Tiranë dhe nga 1 procedim penal është rregjistruar në Elbasan, Korçë dhe Vlorë.


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, në vitin 2009 prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 109/b “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, për 100.000 banorë në vitin 2009 është 0,75, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,37 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 11,11% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 24,24% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re ulje e numrit të procedimeve për gjykim në vitin 2009 prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2008; vihet re rritje e të pandehurve të rregjistruar prej 33,33% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me ulje rezultojnë të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 55,55% (për qind) dhe rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka rritje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009 prej 66,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 16,66% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 70% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara prej 29,41% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal "Shtrengimi me ane të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë" prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj vepre penale, nga të dhënat statistikore rezultojnë se gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 17 procedime pranë Prokurorisë për Krime të Rënda; 3 procedime penale janë rregjistruar në lezhë; 2 procedime penale janë rregjistruar në Tiranë dhe nga 1 procedim penal është rregjistruar në Elbasan dhe në Korçë.


Në këtë grup veprash penale vihet re tendeca për ulje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal "Heqja e paligjshme e lirisë", në vitin 2009 prej 16% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 110 "Heqja e paligjshme e lirisë", për 100.000 banorë në vitin 2009 është 1.31, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 1.57 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 46,29% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 42,42% (për qind) në vitin 2009.


Nga të dhënat statistikore vihet re numër i njëjtë të procedimeve për gjykim në vitin 2009 dhe në vitin 2008; vihet re ulje e të pandehurve të rregjistruar prej 14% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me ulje rezulton të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 16,21% (për qind) dhe rezulton nga të dhënat statistikore se ka rritje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009 prej 116,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 8,57% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara prej 7,89% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 42,85% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë” prej 16% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, grafiku i mëposhtëm paraqet procedimet e rregjistruara sipas rretheve dhe përqindjet përkatëse:



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në rrethin e Tiranës janë rregjistruar 11 procedime penale për këtë veprë penale ose 27% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Durrës janë rregjistruar 9 procedime penale për këtë veprë penale ose 21% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Fier janë rregjistruar 4 procedime penale për këtë veprë penale ose 10% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Berat, Gjirokastrë, Krujë, Kurbin, Shkodër dhe Vlorë janë rregjistruar nga 2 procedime penale për këtë veprë penale ose nga 5% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Dibër, Elbasan, Korçë, Kukës, Lezhë dhe Prokurorinë për Krimë të Rënda janë rregjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale ose 2% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi.

VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME SHFRYTËZIMIN DHE USHTRIMIN E PROSTITUCIONIT

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 2.7 ndërsa për vitin 2009 është 2,28. Është e qartë tendeca për rënie, megjithëse e lehtë, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 0,49% (për qind) për vitin 2008 dhe 0,43% (për qind) për vitin 2009 përkundërt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen trafiqet e paligjshme.

Shfrytëzimi Prostitucionit	2008	2009

	Nr. Procd. Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 113 Prostitucioni	27	31	33	39	49	37	28	45	43	39
Neni 114 Shfrytezim prostitucioni	21	16	19	20	8	16	10	8	12	14
Neni 114/a Shfrytezim prostitucioni renduese	37	15	24	19	33	19	11	11	21	24
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion	1	1	1	1	2	1	1	3	3	1
TOTALI	86	63	77	79	92	73	50	67	79	78

Nga të dhënat rezultojnë se në vitin 2009 ka një ulje prej 15,11% (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për veprat penale që lidhen me shfrytëzimin dhe ushtrimin e prostitucionit, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq kemi ulje të procedimeve të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 20,63% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 12,98% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë me të njëjtat shifra numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 79 në të dy vitet në referencë dhe ulje të të pandehurve të dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 15,2% (për qind) në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 89 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 98 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 9,18% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezultojnë se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është i njëjtë me numrin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2008 (79 të pandehur). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 88,76% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 80,61% (për qind).

Nga të pandehurit në total, të mitur rezultojnë të jenë 4 femra; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) rezultojnë 36 meshkuj dhe 36 femra.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezultojnë ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 47 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jenë 36 të pandehur meshkuj, pra rezultojnë me rritje prej 23,4% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë 36 të pandehura femra në vitin 2009 përkundrejt vitit 2008 kur janë rregjistruar të pandehura 39 femra, pra me ulje prej 7,69% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 58 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar në vitin 2009 përkundrejt 75 të tillëve në vitin 2008 (tregues që rezultojnë me ulje prej 22,66% për qind, në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 18 të pandehur rezultojnë të jenë me

arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrejt 13 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me rritje prej 38,46% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); asnjë nga të pandehurit nuk rezulton të jetë me arsim të lartë për këtë grup veprash penale.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 8 të pandehur që do të thotë se ky tregues rezulton me rritje prej 60% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 dhe të papunë rezultojnë nga të dhënat statistikore 43 të pandehur, që do të thotë ulje prej 12,24% (për qind) e këtij treguesi në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Nga sektori shtetëror nuk është rregjistruar asnjë i pandehur në vitin 2009.

Rezulton se 64 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë ulje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 7,24% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 7 prej tyre në komuna, që do të thotë një ulje të të pandehurve me vendbanim në komunë për këtë grup veprash penale në vitin 2009 prej 63,15% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë (69 të pandehur, që do të thotë ulje prej 15,85% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi. Me rritje paraqitet gjendja gjyqësore e të pandehurve “përsëritës për vera penale të ndryshme” dhe rritja rezulton të jetë në vitin 2009 më 3 të pandehur në vitin 2009 përkundrejt asnjë të pandehuri më këtë gjëndje gjyqësore në vitin 2008. Me ulje paraqitet gjendja gjyqësore e të pandehurve “përsëritës për të njëjtën vepër penale” dhe ulja rezulton të jetë në vitin 2009 në masën 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale rezuktojnë me tendencë veprat penale të parashikuara nga nenet:

- Neni 113 “Prostitucioni”
- Neni 114 “Shfrytëzimi i prostitucionit”;
- Neni 114/a “Shfrytëzimi i Prostitucionit në Rrethana Rënduese.


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni” në vitin 2009 prej 37% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni” në vitin 2009 është 1.6, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,85 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 31.39% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 50,68% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re ulje e procedimeve për gjykim në vitin 2009 prej 9,67% (për qind) në krahasim me vitin 2008; vihet re rritje e të pandehurve të rregjistruar prej 36,36% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me rritje rezulton të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 10,25% (për qind) dhe rezulton nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009 prej 20,4% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 157,14% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 36,11% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 44,89% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të rregjistruara dhe në vitin 2009 ka një rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 37% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, për veprën penale të parashikuar nga neni 113 "Prostitucioni" theksojmë se: në Durrës, në vitin 2009 janë rregjistruar 10 procedime penale përkundërt 3 procedimeve të rregjistruara në vitin 2008; në elbasan dhe fier janë rregjistruar në vitin 2009 nga 3 procedime penale, përkundërt 1 procedimi penal të rregjistruar në vitin 2008; në Tiranë janë rregjistruar 15 procedime penale për këtë veprë penale në të dy vitet; në Vlorë në të dy vitet janë rregjistruar nga 1 procedim penal; në pogradec dhe berat në vitin 2009 janë rregjistruar nga 1 procedim penal në vitin 2009, ndërsa në vitin 2008 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal; Korçë dhe Sarandë, në vitin 2009 nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal, ndërkohë në vitin 2008 kanë rregjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale; në Lezhë, në vitin 2009 janë rregjistruar 2 procedime penale, në vitin 2008 është rregjistruar 1 procedim penal dhe në Lushnje, në vitin 2009 është rregjistruar 1 procedim penal në vitin 2009, ndërsa në vitin 2008 janë rregjistruar 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 113 I Kodit penal "Prostitucioni".

Më poshtë paraqitet shpërndarja gjeografike për veprën penale të parashikuar nga neni 113 "Prostitucioni" për vitin 2009 sipas rretheve dhe përqindjet përkatëse, duke marrë në referencë procedimet e rregjistruara.

Shpërndarja gjeografike Neni 113 "Prostitucioni"



Rrethe që nuk janë përfshirë në grafikun e mësipërm, rezultojnë nga të dhënat statistikore se nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal "Prostitucioni".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal "Shfrytëzimi i Prostitucionit" në vitin 2009 prej 23.8% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal "Shfrytëzimi i Prostitucionit" për 100.000 banorë në vitin 2009 është 0.5, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,66.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 24.4% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 21,9% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re ulje e procedimeve për gjykim në vitin 2009 prej 37,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008; vihet re ulje e të pandehurve të rregjistruar prej 57,89% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me ulje rezultojnë të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 40% (për qind) dhe rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka rritje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009 prej 75% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 114 "Shfrytëzimi i prostitucionit" 2005-2009



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të rregjistruara dhe në vitin 2009 ka një ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 23,8% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike theksojmë se, në vitin 2009 janë rregjistruar 3 procedime penale për këtë veprë penale në Berat dhe në Durrës; janë rregjistruar 2 procedime penale në Korçë dhe 6 procedime penale në Tiranë. Në vitin 2008, nga të dhënat statistikore, rezulton se janë rregjistruar 4 procedime në Fier, në vitin 2009 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal; nga 1 procedim penal për këtë veprë penale është rregjistruar përkatësisht në Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Shkodër dhe Lushnjë; në Tiranë janë rregjistruar 9 procedime penale dhe në Vlorë janë rregjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 114 I Kodit Penal “Shfrytëzimi i Prostitucionit”.


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal “Shfrytëzimi i Prostitucionit në rrethana rënduese” në vitin 2009 prej 48,64% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 114/a i Kodit Penal “Shfrytëzimi i Prostitucionit në rrethana rënduese” për 100.000 banorë në vitin 2009 është 0.59, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 1,16 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 43% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 26% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re ulje e procedimeve për gjykim në vitin 2009 prej 26,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008; vihet re ulje e të pandehurve të rregjistruar prej 54,16% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me ulje rezulton të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 10,52% (për qind) dhe rezulton nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009 prej 27,27% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj veprë penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 38,7% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara prej 16,27% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 2,7% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të rregjistruara dhe në vitin 2009 ka një ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 48,64% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, duke marrë në referencë vitet 2008 dhe 2009, nga të dhënat statistikore rezultoni se:

Në Korçë, Krujë, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Pogradec, në vitin 2008 është rregjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale. Ndërkaq, në vitin 2009 vetëm në Korçë është rregjistruar 1 procedim penal, prokuroritë e tjera përmesbndur sa më sipër nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale. Në Lushnjë, në të dy vitet janë rregjistruar nga 2 procedim penal. Në Vlorë, në vitin 2008 janë rregjistruar 4 procedime penale ndërsa në vitin 2009 janë rregjistruar 2 procedime penale për këtë veprë penale. Në Tiranë, në vitin 2008 janë rregjistruar 5 procedime penale, në vitin 2009 janë rregjistruar 2 procedime penale për këtë veprë penale. Në Berat dhe Elbasan, në vitin 2008 janë rregjistruar nga 6 procedime penale ndërsa në vitin 2009 janë rregjistruar përkatësisht 3 dhe 4 procedime penale për këtë veprë penale. Në Durrës, në vitin 2008 janë rregjistruar 3 procedime penale ndërsa në vitin 2009 është rregjistruar vetëm 1 procedim penal. Në Fier, në vitin 2008 janë rregjistruar 7 procedime penale dhe në vitin 2009 ka një ulje të ndjeshme duke u rregjistruar vetëm 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a i Kodit penal “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”.

Më poshtë paraqitet shpërndarja gjeografike për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” për vitin 2009 sipas rretheve dhe përqindjet përkatëse, duke marrë në referencë procedimet e rregjistruara.

Shpërndarja gjeografike neni 114/a "Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese"



Rrethe, të cilët nuk gjenden në grafik, rezultojnë nga të dhënat statistikorese nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal "Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese".

PËR VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 2.68 ndërsa për vitin 2009 është 2,69 për 100.000 banorë. Tendenca është për rritje, megjithëse e lehtë, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 0,48% (për qind) për vitin 2008 dhe 0,50% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me korrupsionin.

Vepra penale që lidhen me Korrupsion	2008					2009				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 164/a Korrupsion aktiv privat	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0
Neni 164/b Korrupsion pasiv privat	2	2	6	6	1	2	1	2	2	5
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave me funksione publike	7	2	7	7	5	2	2	5	5	2
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionare te	5	5	4	11	5	7	1	1	2	6

Neni 245/1 ushtrimi i ndikimit të përs. të paligj. ndaj përs. qe ushtr. funks.publik	3	1	2	1	0	6	3	6	6	3
Neni 259 Korrupsion pasiv i përs. me funksione publike	59	16	26	31	28	63	16	30	34	20
Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionareve të lartë	2	0	0	1	1	1	1	0	2	0
Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspërtit, ose përkthyesit	1	0	2	0	0	2	1	0	2	0
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit	4	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/a Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit	1	1	1	1	0	2	0	0	0	0
Neni 328 Dhenia e shpërblimeve,	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Totali	85	28	50	59	40	86	25	44	53	36

Nga të dhënat rezultojnë se në vitin 2009 ka një rritje prej 1,176% (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për veprat penale që lidhen me korrupsionin, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq kemi ulje të procedimeve të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 10,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ose 3 çështje më pak.

Në lidhje me të pandehurit rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 12% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë me ulje numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 10,16% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 ose 3 përs. më pak. Rezultojnë me ulje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 10% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 ose 4 përs. më pak;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 89 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 82 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 8,53% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Në këtë tendencë nuk janë përfshirë “përs. nën hetim”, tregues i cili nuk rezultojnë nga të dhënat statistikore.

Rezultojnë se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 53 që do të thotë 10% (për qind) më pak se në vitin 2008 (59 të pandehur).

Të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 43 meshkuj dhe asnjë femër gjatë vitit 2009.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezultojnë rritje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 33 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 43 të pandehur meshkuj, pra rezultojnë me rritje prej 30,30% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin

2008. Rezultojnë 2 të pandehura femra në vitin 2008, ndërkaq në vitin 2009 nuk rezulton asnjë e tillë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 4 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009 dhe në vitin 2008; 15 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrejt 9 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me rritje prej 66,66% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 24 të pandehur rezultojnë me arsim të lartë në vitin 2009 përkundrejt 22 të pandehur me arsim të lartë në vitin 2008, që do të thotë rritje prej 9% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 3 të pandehur që do të thotë se ky tregues rezulton me ulje prej 40% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 dhe të papunë rezultojnë nga të dhënat statistikore 5 të pandehur, që do të thotë rritje prej 1,5 herë e këtij treguesi në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Nga sektori shtetëror rezultojnë 25 të pandehur të rregjistruar në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 1,8 herë në krahasim me vitin 2008. Gjithashtu, rezulton nga të dhënat statistikore se 12 të pandehur janë “nëpunës të nivelit të mesëm” në vitin 2009, nga 1 të tillë në vitin 2008; 1 i pandehur rezulton të jetë nëpunës i nivelit të lartë në vitin 2009 përkundrejt 4 të pandehur të tillë në vitin 2008; 7 të pandehur rezultojnë të jenë “nëpunës të thjeshtë” në vitin 2009, përkundrejt 4 në vitin 2008;

Rezulton se 34 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë rritje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 13,33% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 3 prej tyre në komuna, që do të thotë një ulje të të pandehurve me vendbanim në komunë për këtë grup veprash penale në vitin 2009 prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 43 të pandehur janë të padënuar më parë, që do të thotë rritje prej 22,85% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale rezultojnë me tendencë veprat penale të parashikuara nga nenet:

- Neni 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”
- Neni 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”;
- Neni 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.
- Neni 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë;
- Neni 319/a “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2009 prej 71,42% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në vitin 2009 është 0.062, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,22 krime për 100.000 banorë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 8.2% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 2,3% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re numër i njëjtë i procedimeve për gjykim në vitin 2009 dhe në vitin 2008, 2 procedime penale; vihet re ulje e të pandehurve të rregjistruar prej 28,57% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me ulje rezulton të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 28,57% (për qind) dhe rezulton nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009 prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj veprë penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

**Neni 244 "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike"
2005-2009**



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2005 janë rregjistruar 2 procedime penale për këtë veprë penale; në vitin 2006 janë rregjistruar 5 procedime penale; në vitin 2007 janë rregjistruar 4 procedime penale; në vitin 2008 janë rregjistruar 7 procedime penale dhe në vitin 2009 janë rregjistruar 2 procedime penale, për veprën penale të parashikuar nga neni 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë veprë penale, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2009 në Tiranë dhe në Vlorë janë rregjistruar nga një procedim penal. Në krahasim me vitin 2008, rezulton se në Shkodër dhe Vlorë janë rregjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale dhe në Tiranë janë rregjistruar 5 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga Neni 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2009 prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar Neni 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, në vitin 2009 është 0.18, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,09 krime për 100.000 banorë.


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 3.5% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 6.9% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re rritje e procedimeve për gjykim në vitin 2009 prej 2 herë në krahasim me vitin 2008; vihet re rritje e të pandehurve të rregjistruar prej 2 herë në vitin 2009

në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me rritje rezulton të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 5 herë në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 dhe rezulton nga të dhënat statistikore se ka rritje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009, me 3 të pandehur dënuar përkundrejt asnjë të pandehuri të dënuar në vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 245/1 "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike"



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitet 2005 dhe 2006 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në vitin 2007 janë rregjistruar 2 procedime penale; në vitin 2008 kam një rritje prej 50% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Njëri nga procedimet e rregjistruara gjatë vitit 2009, për këtë veprë penale është në ngarkim të një prokurori, procedim i cili është rregjistruar kryesisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, për këtë veprë penale, theksojmë se 3 procedime penale janë rregjistruar në Durrës në vitin 2009, përkundrejt 1 procedimi penal të rregjistruar në vitin 2008; 2 procedime penale janë rregjistruar në Shkodër në vitin 2009, përkundrejt asnjë procedimi penal të rregjistruar në vitin 2008; në Lushnjë, është rregjistruar 1 procedim penal në vitin 2009, përkundrejt asnjë procedimi të rregjistruar në vitin 2008;

Në vitin 2008 janë rregjistruar në Berat e Durrës, përkatësisht nga 2 dhe 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni Neni 245/1 "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendeca për rritje të procedimeve të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga Neni 259 "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në vitin 2009 prej 6,77% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar Neni 259 "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", në vitin 2009 është 1.97, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 1,86 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 69,41% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 73,25% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është i njëjtë me vitin 2008, 16 procedime për gjykim; vihet re rritje e të pandehurve të rregjistruar prej 15,38% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; gjithashtu, me rritje rezultojnë të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 9,65 (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 dhe rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të dënuar në vitin 2009, me 28,57% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):


**Neni 259 "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrjnë funksione publike"
2005-2009**



Rezultojnë nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka një rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 86,66% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 21,42% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 73,52% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 6,77% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja e procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009, sipas rrethëve:

Neni 259 "Korrupsioni pasiv i personave qe ushtrojne funksione publike"



Në rrethet, Berat, Krujë, Lushnje, Pogradec dhe Pukë gjatë vitit 2009 janë rregjistruar përkatësisht nga 1 procedim penal ose nga 25 (për qind) të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; Korçë, janë rregjistruar 2 procedime penale ose 3% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Lezhë dhe Vlorë janë rregjistruar nga 3 procedime penale ose 5% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara; në Gjirokastër, janë rregjistruar 5 procedime penale ose 8% e procedimeve në total; në Durrës dhe Fier janë rregjistruar nga 6 procedime penale ose përkatësisht nga 9% (për qind) dhe 10% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; Shkodër janë rregjistruar nga 7 procedime penale ose 10% (për qind) dhe 10% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; Elbasan, janë rregjistruar 8 procedime penale ose 12% (për qind) dhe 10% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Tiranë, janë rregjistruar 18 procedime penale ose 28% (për qind) dhe 10% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga Neni 319/a "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë", rezulton nga të dhënat statistikore se gjatë vitit 2009 janë rregjistruar 2 procedime penale, në krahasim me vitin 2008 kur është rregjistruar 1 procedim penal. Të dy këto procedime penale të rregjistruara gjatë vitit 2009 janë në ngarkim të dy gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë Elbasan dhe Vlorë, për të cilët është kërkuar heqja e imunitetit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe është autorizuar procedimi penal ndaj tyre. Ndërkohë që në një procedim penal të rregjistruar kryesisht ndaj 1 prokurori të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është evidentuar përgjegjësia penale edhe e 1 (një) gjyqtareje të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për të cilën gjithashtu është kërkuar heqja e imunitetit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe është autorizuar procedimi penal ndaj saj.

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME DETYRËN

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 20 ndërsa për vitin 2009 është 14.68 krime për 100.000 banorë. Tendenca është për ulje, megjithëse e lehtë, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 3,65% (për qind) për vitin 2008 dhe 2,77% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit total

të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me detyrën.

Vepra penale te lidhura me detyren	2008					2009				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 248 Shpërdorim detyre	474	102	186	184	81	399	73	112	180	127
Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhenies fund te tij.	7	3	12	4	2	3	1	2	1	1
Neni 250 Kryerja e veprimeve arbitrare	77	10	28	18	9	41	6	9	7	9
Neni 251 Mosmarrja e masave për te nderprere gjendj. e paligjshme	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 252 Mbjajta ne burg pa vendim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 253 Shkelja e barazise se shtetasve	1	0	2	0	0	1	0	2	0	0
Neni 254 Shkelja e paprekshmerise se baneses	1	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtesise se korresp	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 256 Shpërdorim i kontributeve te dhena nga shteti	11	1	3	2	0	1	0	0	0	0
Neni 257 Përfitim i paligjshem i interes.	5	5	5	5	4	0	0	0	0	2
Neni 257/a Refuzimi për deklarim, mosdekl., fshehja ose dekl. rreme i pasuri. te përs. te zgjedhur dhe nepunesve publ.	23	12	11	12	7	12	10	8	10	8
Neni 258 Shkelja e barazize ne tendera	23	6	15	30	19	10	7	1	34	28
Neni 70 KPU Shpërdorim detyre	12	3	12	3	4	2	0	4	0	0
Totali	635	143	274	259	126	469	97	138	232	175

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2009 ka një ulje prej 26,14% (për qind) të procedimeve të rregjistruara për veprat penale që lidhen me detyrën, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq kemi ulje të procedimeve të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 32,16% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit rezulton nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 49,63% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezulton me ulje të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 10,42% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezulton me rritje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Ne lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 303 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 441 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 31,29% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 206 që do të thotë 20,46% (për qind) më pak se në vitin 2008 (259 të pandehur). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 67,98% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 58,73% (për qind).

Nga të pandehurit në total, të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 149 meshkuj dhe 18 femra.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezulton ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 233 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 149 të pandehur meshkuj, pra rezulton me ulje prej 36% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë 18 të pandehura femra në vitin 2009 përkundrejt 22 të pandehura femra, të rregjistruar në vitin 2008, që do të thotë ulje prej 18,18% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 9 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009 dhe 10 në vitin 2008; 41 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrejt 100 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje prej 59% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 117 të pandehur rezultojnë me arsim të lartë në vitin 2009 përkundrejt 139 të pandehur me arsim të lartë në vitin 2008, që do të thotë ulje prej 15,82% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezultoni nga të dhënat statistikore se, në vitin 2005 dhe 2007 janë rregjistruar nga 2 procedime penale për këtë veprë penale; në vitin 2006 janë rregjistruar 3 procedime penale për këtë veprë penale; në vitin 2008 janë rregjistruar 4 procedime penale për këtë veprë penale dhe në vitin 2009 janë rregjistruar 7 procedime penale.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, theksojmë se për këtë veprë penale janë rregjistruar në vitin 2009 nga 1 procedim penal në Durrës dhe Pogradec. Në Tiranë janë rregjistruar 5 procedime penale. Ndërkohë, në vitin 2008 janë rregjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale në rrethet: Durrës, Fier, Pogradec dhe Vlorë.

PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 7,6 ndërsa për vitin 2009 është 7.4 krime për 100.000 banorë. Tendenca është për rritje, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 1.39% (për qind) për vitin 2008 dhe 1.4% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me shoqëritë tregtare.

Krime në Fushën e Goganave	2008					2009				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet	15	8	13	11	5	17	12	19	17	19

akcizë										
Neni 173 Kontrabanda me mallra të licensuar	0	1	0	1	1	5	3	3	3	2
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	98	39	52	50	47	125	38	60	45	33
Neni 175 Kontrabanda nga punënjës që lidhen me veprimtarinë doganore	4	1	5	1	0	2	1	5	1	0
Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	12	6	10	7	7	9	1	3	1	2
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	99	68	98	74	57	60	17	42	20	25
Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrab.	5	6	3	6	8	5	5	5	6	6
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	8	5	8	5	6	14	11	12	12	13
Totali	242	134	190	154	131	237	88	149	105	102

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2009 ka një ulje prej 2% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për veprat penale që lidhen me shoqëritë tregtare, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq me ulje procedimet të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 34,32% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit rezulton nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 21,57% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë me ulje të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 31,81% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë me ulje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 22% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 211 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 232 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 9% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 105 që do të thotë 32,25% (për qind) më pak se në vitin 2008 (155 të pandehur dërguar gjyqit). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në

raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 49,76% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 66,8% (për qind).

Të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 117 të pandehur. Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezulton ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 150 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 115 të pandehur meshkuj, pra rezulton me ulje prej 23,33% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2008 numri i të pandehurave femra ka qenë 7 të pandehura ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 2 të pandehura femra, pra rezulton me ulje prej 71,42% (për qind) e numrit të të pandehurave femra në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur të huaj, nga të dhënat statistikore rezultojnë 2 në vitin 2009 dhe 4 të pandehur të huaj në vitin 2008.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 59 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009, e njëjtë shifra më vitin 2008 për këtë tregues; 47 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrejt 92 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje prej 48,9% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 11 të pandehur rezultojnë me arsim të lartë në vitin 2009, përkundrejt 15 në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje në masën 26,66% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008).

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 46 të pandehur; nga sektori shtetëror rezultojnë 4 të pandehur që do të thotë rritje prej 33,33% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezulton 1 i pandehur “nëpunës i nivelit të lartë”, 1 i pandehur “nëpunës i nivelit të mesëm” dhe 2 të pandehur “nëpunës i thjeshtë”. Në vitin 2009 rezultojnë se 69 të pandehur janë të papunë, pra me ulje prej 15,85 (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se 95 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë ulje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 11,2% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 22 prej tyre në komuna, që do të thotë një ulje të të pandehurve me vendbanim në komunë për këtë grup veprash penale në vitin 2009 prej 55% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, 114 të pandehur janë të padënuar më parë (që do të thotë ulje prej 24% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi. 2 të pandehur përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 1 i pandehur përsëritës për të njëjtën veprë penale.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 173 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të licencuar”.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni Neni 173 “Kontrabanda me mallra të licencuara” vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në vitin 2009. Janë rregjistruar 5 procedime penale për këtë veprë penale përkundrejt vitit 2008, kur nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të 173 “Kontrabanda me mallra të licencuara”, në vitin 2009 është 0,15, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 0% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 2% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur në masën 200% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar, kështu në vitin 2009 janë rregjistruar 3 të pandehur, ndërsa në vitin 2008 është rregjistruar 1 i pandehur; gjithashtu, me rritje rezultojnë të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 2 herë në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehurit të dënuar nga gjykata për këtë veprë penale, në vitin 2009 është 2 ndërsa në vitin 2008, rezultojnë 1 i pandehur i dënuar nga gjykata.

Dinamika e kësaj veprë penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 173 "Kontrabanda me mallra të licencuar"
2005-2009



Rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2005 dhe në vitin 2006 është rregjistruar nga 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal "Kontrabanda me mallra të licencuar"; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale prej 3 herë në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale dhe në vitin 2009 janë rregjistruar 5 procedime penale për këtë veprë penale.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, për këtë veprë penale, theksojmë se 2 procedime penale janë rregjistruar në Kukës, dhe nga një procedim penal është rregjistruar në Durrës, Gjirokastrë dhe Korçë.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal "Kontrabanda me mallra të tjera".

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni Neni 174 "Kontrabanda me mallra të tjera" vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara në vitin 2009 prej 27,55% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të 174 "Kontrabanda me mallra të tjera", në vitin 2009 është 3,9, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 3 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 40% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 52% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur në masën 2,56% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar, kështu në vitin 2009 janë rregjistruar 15,38% (për qind) më shumë se në vitin 2008; me ulje rezultojnë të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 10% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë veprë penale, në vitin 2009 është ulur prej 29,78% (për qind) në krahasim me vitin.

Dinamika e kësaj veprë penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:


Neni 174 "Kontrabanda me mallra të tjera" 2005-2009



Rezultojnë nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 55% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 47,11% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara prej 57% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 27,55% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Shpërndarja gjeografike, më poshtë paraqitet grafikisht (në nëndarjen "Të tjerë janë përfshirë rrethë të cilët kanë rregjistruar nga 1 procedim penal):

Neni 174 "Kontrabanda me mallra te tjera"



Në Berat, Kavajë, Lushnje dhe Mat, nuk është rregjistruar asnjë procedim penal në të dy vitet; në Dibër, janë rregjistruar 2 procedime penale në vitin 2009, ose 2% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë ulje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Elbasan, janë rregjistruar 2 procedime penale në vitin 2009, ose 2% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë ulje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Fier nuk është rregjistruar asnjë procedim në vitin 2009, përkundëjt vitit 2008 kur janë rregjistruar 2 procedime penale; në Kurbin nuk është rregjistruar asnjë procedim në vitin 2009, përkundëjt vitit 2008 kur është rregjistruar 1 procedim penal; ; në Pukë nuk është rregjistruar asnjë procedim në vitin 2009, përkundëjt vitit 2008 kur janë rregjistruar 2 procedime penale; në Sarandë, është rregjistruar 1 procedim penal në vitin 2009, përkundëjt 2 procedimeve penale të rregjistruara në vitin 2008; në Shkodër është rregjistruar 1 procedim penal në vitin 2009, përkundëjt vitit 2008 kur janë rregjistruar 5 procedime penale; në Tiranë, janë rregjistruar 18 procedime penale në vitin 2009, ose 14% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë rritje prej 12,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008; Durrës, janë rregjistruar 21 procedime penale në vitin 2009, ose 11% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë rritje prej 61,53% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Gjirokastrë, janë rregjistruar 13 procedime penale në vitin 2009, ose 10% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë rritje prej 62,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Korçë, janë rregjistruar 18 procedime penale në vitin 2009, ose 14% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë rritje prej 80% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Kukës, janë rregjistruar 24 procedime penale në vitin 2009, ose 20% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë rritje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Lezhë, janë rregjistruar 4 procedime penale në vitin 2009, ose 3% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë rritje prej 3 herë në krahasim me vitin 2008; në Pogradec, janë rregjistruar 3 procedime penale në vitin 2009, ose 2% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë ulje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në Vlorë, janë rregjistruar 14 procedime penale në vitin 2009, ose 11% e totalit të procedimeve të rregjistruara, që do të thotë rritje prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në tropjë në të dy vitet janë rregjistruar nga 3 procedime penale, për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga Neni 178 “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në vitin 2009 prej 39,39% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 178 “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, në vitin 2009 është 1.8, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 3.1 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 40% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 25,31% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur në masën 75% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezulton të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar, kështu në vitin 2009 janë rregjistruar 57,14% (për qind) më pak se në vitin 2008; me ulje rezulton të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 72,97% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është ulur prej 56,14% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:


**Neni 178 "Tregtimi dhe transportimi i mallrave qe jane kontrabande"
2005-2009**



Rezulton nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 4% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 4,16% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 98% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 39,39% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Shpërndarja gjeografike, për veprën penale të parashikuar nga neni 178 “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë” paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 178 "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabande"



Në Dibër dhe Pukë është rregjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale ose 2% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; në Kavajë, Kukës, Lezhë, dhe Shkodër, janë rregjistruar nga 2 procedime penale ose 3% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; në Durrës dhe Vlorë, janë rregjistruar nga 3 procedime penale ose 5% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; në Gjirokastrë, janë rregjistruar nga 4 procedime penale ose 7% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; në Sarandë, janë rregjistruar 2 procedime penale ose 8% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë republike; ; në Elbasan, janë rregjistruar 6 procedime penale ose 10% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë republike dhe në Tiranë janë rregjistruar 29 procedime penale për këtë veprë penale ose 49% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë".

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga 179/a i Kodit Penal "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë" vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale në vitin 2009 prej 75% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë", në vitin 2009 është 0,4, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,2 krime për 100.000 banorë. Ky koeficient quhet shifra relative e intensitetit që përbëhet nga, shifra raportuese, që në këtë rast shpreh nivelin e fenomenit, ndërsa emëruesi shpreh nivelin e fenomenit në ambjentin ku zhvillohet ky fenomen.


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 3,3% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 5,9% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur në masën 120% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar, kështu në vitin 2009 janë rregjistruar 50% (për qind) më shumë se në vitin 2008; me rritje rezultojnë të jetë edhe numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 140% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të

pandehur të dënuar nga gjykata për këtë veprë penale, në vitin 2009 është rritur prej 116,66% (për qind) në krahasim me vitin.

Dinamika e kësaj veprë penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 179/a "Mosdeklarimi ne kufi i te hollave" 2005-2009



Rezulton nga të dhënat statistikore se, në vitin 2005 është rregjistruar 1 procedim penal për këtë veprë penale; në vitin 2006 janë rregjistruar 3 procedime penale; në vitin 2007 janë rregjistruar 4 procedime penale; në vitin 2008 janë rregjistruar 8 procedime penale për këtë veprë penale dhe në vitin 2009 janë rregjistruar 14 procedime penale për këtë veprë penale.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike theksojmë se në vitin 2009, 12 procedime penale janë rregjistruar në Tiranë, dhe nga 1 procedim penal është rregjistruar në Vlorë dhe në Durrës. Në vitin 2008, nga 1 procedim penal është rregjistruar në Elbasan, Gjirokastër dhe Vlorë dhe 5 procedime penale janë rregjistruar në Tiranë.

VEPRAT PENALE NE LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 3,6 ndërsa për vitin 2009 është 3 krime për 100.000 banorë. Tendeca është për ulje, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 0,66% (për qind) për vitin 2008 dhe 0,57% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me shoqëritë tregtare.

Taksa e Tatime	2008					2009				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar

Neni 180 Fshehja e të ardhurave	21	3	4	3	1	5	3	1	11	10
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	91	25	43	25	20	92	28	29	28	26
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	116	28	47	28	21	97	31	30	39	36

Nga të dhënat rezultojn se në vitin 2009 ka një ulje prej 16,37% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për veprat penale që lidhen me shoqëritë tregtare, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq me rritje janë procedimet të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 10,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit rezultojn nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 36,17% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezultojn me rritje të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 39,28% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezultojn me rritje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 71,42% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 77 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 58 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 32,75% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezultojn se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 39 që do të thotë 39,28% (për qind) më pak se në vitin 2008 (28 të pandehur dërguar gjyqit). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 50,64% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 48,27% (për qind).

Të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 33 të pandehur. Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezultojn ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 44 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 30 të pandehur meshkuj, pra rezultojn me ulje prej 31,81% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2008 numri i të pandehurve femra ka qenë 4 të pandehura ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 3 të pandehura femra, pra rezultojn me ulje prej 25% (për qind) e numrit të të pandehurve femra në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojn se 8 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009, që do të thotë ulje prej 65,21% (për qind) në krahasim me vitin 2008; 15 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrajt 24 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezultojn me ulje prej 37,5% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 10 të pandehur rezultojnë me arsim të lartë në vitin 2009, përkundrajt 1 në vitin 2008 (tregues që rezultojn me rritje prej 3 herë në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008).

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 23 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në ulje prej 36,11% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2009 rezultojnë se 4 të pandehur janë të papunë, pra me rritje prej 33,33 (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Rezultoni se 32 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë rritje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 52,38% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 1 prej tyre në komuna, që do të thotë se jemi në të njëjtat nivele si edhe në vitin 2008.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, 33 të pandehur janë të padënuar më parë (që do të thotë rritje prej 50% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni Neni 180 “Fshehja e të ardhurave” vihet re tendenca për rritje e procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009 janë rregjistruar 5 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 76,19% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 180 “Fshehja e të ardhurave”, në vitin 2009 është 0,15, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,66 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 18% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 5% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është i njëjtë me vitin 2008, 3 procedime penale; në vitin 2009 me ulje rezultoni të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar, kështu në vitin 2009 është rregjistruar 1 i pandehur, që do të thotë ulje prej 75% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultoni me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 266,66%(për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultoni se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur 9 herë në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 180 "Fshehja e te ardhurave" 2005-2009



Rezultoni nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 61% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 27,58% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 jemi në të njëjtat nivele, 21 procedime penale sikurse dhe në vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 76% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjografike, për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal "Fshehja e të ardhurave", theksojmë se në vitin 2009 është rregjistruar 1 procedim penal në Durrës, Fier dhe Shkodër dhe 2 procedime penale janë rregjistruar në Korçë. Në vitin 2008 janë rregjisatruar 9 procedime penale në Elbasan dhe në Shkodër, dhe nga 1 procedim penal në Korçë dhe Tiranë.

PËR VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME FALSIFIKIMIN E MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 1.26 ndërsa për vitin 2009 është 2.84 krime për 100.000 banorë. Tendenca është për rritje, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 0.23% (për qind) për vitin 2008 dhe 0,54% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me shoqëritë tregtare.

Falsifikimi	i	2008	2009

monedhave dhe letrave me vlere	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 183 Falsifikimi i monedhave	37	16	31	29	15	90	25	48	36	16
Neni 184 Falsifikimi i letrave me vlere	3	0	2	0	3	1	0	0	0	0
Neni 185 Prodhimi i mjeteve për falsifikim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	40	16	33	29	18	91	25	48	36	16

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2009 ka një rritje prej 127,5% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për veprat penale që lidhen me falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlere, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq me rritje janë procedimet të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 65,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit rezulton nga të dhënat statistikore se ka rritje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 45,45% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezulton me rritje të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 24,13% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezulton me ulje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 11,11% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 59 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 45 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 31,11% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 36 që do të thotë 24,13% (për qind) më shumë se në vitin 2008 (29 të pandehur dërguar gjyqit). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 61% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 64,44% (për qind).

Të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 27 të pandehur. Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezulton rritje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 15 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 27 të pandehur meshkuj, pra rezulton me rritje prej 80% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur të mitur, (14-18 vjec) rezultojnë në total 8 të pandehur në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Të gjithë janë meshkuj, që do të thotë rritje prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 21 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 2,5 herë në krahasim me vitin 2008; 13 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrejt 15 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje prej 13,33% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008).

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 4 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në rritje prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2009 rezultojnë se 22 të pandehur janë të papunë, pra me rritje prej 29,41 (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Rezultoni se 24 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë rritje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 166,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 10 prej tyre në komuna, që do të thotë se kemi rritje prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, 30 të pandehur janë të padënuar më parë (që do të thotë rritje prej 50% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 183 Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni Neni 183 “Falsifikimi i monedhave”, vihet re tendeca për rritje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 90 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë rritje prej 143,24% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 183 “Falsifikimi i monedhave”, në vitin 2009 është 2.8, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 1.16 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 92.5% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 98.9% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur prej 56,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultoni të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar në masën prej 54,83% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultoni me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 24,13%(për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultoni se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 6,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:


Neni 183 "Falsifikimi i monedhave" 2005-2009



Rezultoni nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 30,76% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 23,52% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi ulje të procedimeve penale prej 5,12% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 143,24% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, për këtë veprë penale, grafiku i mëposhtëm paraqet procedimet penale të rregjistruara sipas rretheve gjatë vitit 2009 dhe përqindjet përkatëse:

Neni 183 "Falsifikimi i monedhave"



Sikurse vihet re edhe nga grafiku, rrethet ku është e përqëndruar kjo veprë penale janë rrethet e Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Durrës, Shkodër dhe Kavajë.

PËR VEPRA PENALE NË LIDHJE ME FALSIFIKIMIN E DOKUMENTEVE

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 55 ndërsa për vitin 2009 është 37 krime për 100.000 banorë. Tendenca është për rritje, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 10% (për qind) për vitin 2008 dhe 7,1% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me shoqëritë tregtare.

Falsifikimi i Dokumenteve	2008					2009				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	1010	366	445	375	302	724	284	253	376	323
Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore	77	42	60	48	59	25	12	14	15	17
Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore	1	2	2	3	0	3	2	4	4	7
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaport.ose viza	338	211	239	235	276	225	175	162	179	194
Neni 190 Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve	195	81	101	105	119	120	44	48	56	64
Neni 191 Falsifikimi i akte. te gjendjes civile	113	54	68	68	68	98	32	44	43	43
Neni 192 Prodhimi i mjeteve për fals. e dokumenteve	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0
Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve	8	2	5	5	4	4	0	0	0	0
Neni 192/b Ndërhyrja në transmetimet kompjuterike	0	1	0	1	1	1	0	0	0	0
Totali	1744	761	922	842	831	1202	549	525	673	648

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2009 ka një ulje prej 31% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për veprat penale që lidhen me shoqëritë tregtare, në krahasim me vitin 2008.

Ndërkaq me ulje janë procedimet të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 27,85% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit rezulton nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 43% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë me ulje të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 20% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezulton me rritje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 22% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 888 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 1174 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 24,36% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 675 që do të thotë 19,83% (për qind) më shumë se në vitin 2008 (842 të pandehur dërguar gjyqit). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 76% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 71,72% (për qind).

Të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 593 të pandehur. Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezulton ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 717 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 531 të pandehur meshkuj, pra rezulton me ulje prej 25,94% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2008 numri i të pandehurve femra ka qenë 137 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jenë 62 të pandehur femra, pra rezulton me ulje prej 54,74% (për qind) e numrit të të pandehurve femra në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur “të mitur” gjithsej rezultojnë të jenë 13 të të pandehur në vitin 2008 që do të thotë ulje prej 7,14% (për qind) në vitin 2008 në krahasim me vitin 2009; nga keta, 11 të pandehur të mitur, rezultojnë të jenë meshkuj, që do të thotë ulje prej 21,42% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe 2 të pandehur rezultojnë të jenë femra, që do të thotë rritje prej 2 herë të këtij treguesi në krahasim me vitin 2008.

Shtetas të huaj të pandehur, rezultojnë në vitin 2009, 83 të pandehur që do të thotë ulje prej 23,85% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 332 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009, që do të thotë uje prej 27,35% (për qind) në krahasim me vitin 2008; 224 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrajt 357 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje prej 37,25% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); me arsim të lartë rezultojnë 47 të pandehur në vitin 2009, që do të thotë ulje prej 11,32% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 88 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në ulje prej 41,33% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Nga sektori shtetëror rezultojnë 29 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në ulje prej 53,22% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2009 rezultojnë se 413 të pandehur janë të papunë, pra me ulje prej 21,33 (për qind) në krahasim me vitin 2008. nga të dhënat statistikore, rezultojnë për këtë grup veprash penale se 3 të pandehur janë funksionarë në vitin 2009, 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të lartë, 7 të pandehur janë nëpunës të nivelit të mesëm, përkundrajt vitit

2008 kur rezultojnë 5 të tillë (rritje prej 40%) në krahasim me vitin 2008; 2 të pandehur rezultojnë të jenë nëpunës i nivelit të ulët në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 77,77% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Rezultoni se 385 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë ulje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 30,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 220 prej tyre në komuna, që do të thotë se kemi ulje prej 30,15% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 584 të pandehur janë të padënuar më parë (që do të thotë ulje prej 30,72% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi. 2 të pandehur rezultojnë të jenë përsëritës për të njëjtën vepër penale (që do të thotë ulje prej 60% në krahasim me vitin 2008) dhe 7 të pandehur rezultojnë të jenë përsëritës për vepra penale të ndryshme, që do të thotë ulje prej 58,82% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni Neni 186 “Falsifikimi i dokumenteve” vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 724 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 28,31% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 186 “Falsifikimi i dokumenteve”, në vitin 2009 është 22.66, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 31.86 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 57,91% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 60% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 22,4% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezultoni të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar në masën prej 43% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultoni me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 0,2%(për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultoni se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 6,95% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Dinamika e kësaj veprë penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 186 "Falsifikimi i dokumenteve" 2005-2009



Rezultoni nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 10,48% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 13,17% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 89,13% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 28,31% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Më poshtë paraqitet grafikisht, shpërndarja gjeografike e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve", numrin e procedimeve të rregjistruar në dy vite, 2008-2009 sipas rretheve:



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve shkollorë".

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni Neni 187 "Falsifikimi i dokumenteve shkollorë" vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 724 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 67,53% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 187 “Falsifikimi i dokumenteve shkollore”, në vitin 2009 është 0.78, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 2.42 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 4,4% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 2% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 71,42% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezulton të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar në masën prej 76,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezulton me ulje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 68,75%(për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është ulur në një masë prej 71% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 187 ""Falsifikimi i dokumenteve shkollore" 2005-2009




Rezulton nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 130% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 97,82% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi ulje të procedimeve penale të rregjistruara prej 15,38% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 67,53% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Më poshtë paraqitet grafiki shpërndarja gjeografike për veprën penale të parashikuar nga neni 187 i Kodit penal “Falsifikimi i dokumenteve shkollore” në vitin 2009, sipas rretheve dhe përqindjet përkatëse.

Kështu, rrethet Dibër dhe Korçë kanë rregjistruar nga 1 procedim penal ose 4% (për qind) e totalit të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi për këtë vepër penale; rrethet Elbasan, Lezhë, Lushnje dhe Tiranë kanë rregjistruar nga 2 procedime penale ose nga 8% (për qind) të procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Vlorë janë rregjistruar 3 procedime penale ose 12% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi dhe në Shkodër janë

rregjistruar 12 procedime penale ose 48% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi.

Neni 187 "Falsifikimi i dokumenteve shkollore" 2005-2009



Rrethe të cilat nuk janë përfshirë në grafik nuk kanë rregjistruar asnjë procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve shkollore".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave".

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave" vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 225 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 33,43% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga 189 i Kodit Penal "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", në vitin 2009 është 7, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 10,66 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 19% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 18,7% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 17% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar në masën prej 32,2% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me ulje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 23,8% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënues nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është ulur në një masë prej 29,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 189 "Falsifikimi i leternjoftimeve, i pasaportave ose i vizave"
2005-2009



Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 76 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në rritje prej 38,18% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2009 rezultojnë se 87 të pandehur janë të papunë, pra me ulje prej 22,32% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se 34 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë ulje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 134 prej tyre në komuna, që do të thotë se kemi ulje prej 10,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, 158 të pandehur janë të padënuar më parë (që do të thotë ulje prej 21,39% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi. Përsëritës për të njëjtën vepër penale rezultojnë 14 të pandehur gjatë vitit 2009, që do të thotë rritje prej 55,55% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit”.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit”, vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 10 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë rritje prej 37,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e mjedisit”, në vitin 2009 është 0.3, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0.5 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 6,77% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 4,48% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar në masën prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me ulje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 62,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 201 "Ndotja e ajrit" 2005-2009



Rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitet 2005 dhe 2006 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër penale; në vitin 2007 janë rregjistruar 2 procedime penale; në vitin 2008 janë rregjistruar 16 procedime penale dhe në vitin 2009 janë rregjistruar 10 procedime penale për këtë vepër penale

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, theksojmë se 10 procedimet penale që janë rregjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit” janë

rregjistruar në Krujë gjatë vitit 2009. Edhe gjatë vitit 2008, të gjitha procedimet penale që janë rregjistruar në shakllë republike, janë rregjistruar në Krujë.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal "Prerja e paligjshme e pyjeve".

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal "Prerja e paligjshme e pyjeve", vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 10 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 6% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 205 i Kodit Penal "Prerja e paligjshme e pyjeve", në vitin 2009 është 5.8, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 6.2 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 83,89% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 83,40% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 13,22% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezulton të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar në masën prej 20,54% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezulton me ulje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 14% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 10% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 205 "Prerja e paligjshme e pyjeve" 2005-2009



Rezulton nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka një rritje prej 29% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin; në vitin 2007 ka ulje prej 21,18 (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi ulje të procedimeve penale të rregjistruara prej 12,77% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 6% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Shpërndarja gjeografike paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Rezulton nga të dhënat statistikore se: në Korçë, janë rregjistruar 84 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 45% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Dibër, janë rregjistruar 23 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 12% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Elbasan, janë rregjistruar 23 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 11% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Shkodër, janë rregjistruar 18 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 10% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Pogradec, janë rregjistruar 6 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 3% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Durrës, Mat, Pukë dhe Vlorë, janë rregjistruar nga 4 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 2% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Berat, Lezhë dhe Tiranë, janë rregjistruar nga 3 procedime penale gjatë vitit 2009, ose nga 2% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Fier, Gjirokastrë, Kukës dhe Sarandë, janë rregjistruar nga 2 procedime penale gjatë vitit 2009, ose nga 1% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Krujë dhe Lushnjë, janë rregjistruar nga 1 procedim penal.

PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHQIPTARË

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 18.89 ndërsa për vitin 2009 është 16.56 krime për 100.000 banorë. Tendeca është për ulje, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 3,45% (për qind) për vitin 2008 dhe 3.12% (për qind) për vitin 2009 përkundërt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për vepra penale kundër autoritetit të shtetit:

Krime kundër Autoritetit të Shtetit	2008					2009				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	27	18	21	21	24	23	15	27	22	8
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	158	138	189	180	162	120	110	152	168	125
Neni 237 Goditjet për shkak të dety.	112	81	104	99	95	106	73	83	80	56
Neni 238 Kanosja për shkak të dety.	28	17	20	19	18	27	13	17	14	13
Neni 239 Fyerja për shkak të dety.	179	61	95	71	42	154	70	96	86	54
Neni 240 Shpifja për shkak të dety.	23	7	11	8	7	21	4	5	4	1
Neni 241 Shpifja ndaj Presidentit të Republikës	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrit të punonj. të pol. rendit	66	46	59	54	41	71	63	72	73	59
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së përsosur që kryen një detyrë shtetërore	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore	3	3	1	11	6	5	2	2	3	4
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës	0	0	0	0	1	2	1	1	1	0
Totali	599	371	501	464	396	529	351	455	451	320

Nga të dhënat rezultojnë se në vitin 2009 ka një ulje prej 11,68% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për veprat penale kundër autoritetit të shtetit, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq me ulje janë procedimet të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 5,39% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit, rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka ulje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 9,18% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë me ulje

të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 2,8% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezulton me ulje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 19,19% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 591 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 634 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 6,78% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 458 që do të thotë 4,9% (për qind) më pak se në vitin 2008 (482 të pandehur dërguar gjyqit). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 77,49% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 76,% (për qind).

Të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 359 të pandehur. Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezulton ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 435 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 355 të pandehur meshkuj, pra rezulton me ulje prej 18,39% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. të pandehura femra, gjatë vitit 2009 rezultojnë 4, përkundrejt vitit 2008 me 15 të pandehura femra, që do të thotë ulje prej 73,33% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur të mitur (14-18 vjec) rezulton nga të dhënat statistikore se janë 9 të tillë në vitin 2009 (meshkuj), përkundrejt 13 të pandehuri të mitur, të rregjistruar për këtë grup veprash penale gjatë vitit 2008, që do të thotë ulje prej 30,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 218 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009, që do të thotë ulje prej 17,42% (për qind) në krahasim me vitin 2008; 130 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrejt 175 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje prej 25,7% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 19 të pandehur rezultojnë me arsim të lartë në vitin 2009, përkundrejt 23 të tillë në vitin 2008, që do të thotë, një ulje prej 17,39% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 83 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në ulje prej 6,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Nga sektori shtetëror, rezultojnë 6 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në ulje prej 45,45% (për qind) në krahasim me vitin 2008. në vitin 2009, 5 të pandehur rezultojnë të jenë “nëpunës i thjeshtë”, që do të thotë ulje prej 54,54% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2009 rezultojnë se 246 të pandehur janë të papunë, pra me ulje prej 2,76% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se 251 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë ulje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 19% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 117 prej tyre në komuna, që do të thotë se kemi ulje prej 21,47% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, 344 të pandehur janë të padënuar më parë (që do të thotë ulje prej 21,28% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi. Përsëritës për të njëjtën vepër penale rezultojnë 2 të pandehur gjatë vitit 2009, që do të thotë ulje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Përsëritës për vepra penale të ndryshme rezultojnë 18 të pandehur gjatë vitit 2009, që do të thotë ulje prej 10% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të dëmtuar-viktima, rezultojnë nga të dhënat statistikore, për këtë grup veprash penale në total 18 (meshkuj), që do të thotë një ulje prej 61,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.


Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 120 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 24% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, në vitin 2009 është 3.75, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 4.98 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 26,37% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 22,68% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar në masën prej 19,57% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me ulje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 6,6% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është ulur në një masë prej 22,83% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:




Rezultojnë nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka një rritje prej 25,77% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 27,86% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 1,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të


procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 24% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Shpërndarja gjeografike paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 236 "Kundershtimi i punonjesit te policise se rendit publik" 2009



Neni 236 "Kundershtimi i punonjesit te policise se rendit publik"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 239 i Kodit Penal "Fyerja për shkak të detyrës".

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 239 i Kodit Penal "Fyerja për shkak të detyrës", vihet re tendenca për ulje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë


rregjistruar 154 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 13,96% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nën 239 i Kodit Penal “Fyerja për shkak të detyrës”, në vitin 2009 është 4.8, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 5.6 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 29,88% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 29,11% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur prej 14,75% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar në masën prej 1,05% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 21,12% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 28,57% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:



Rezultojnë nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka një rritje prej 38,94% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 31,81% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 2,87% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 13,96% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Shpërndarja gjeografike paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 239 "Fyerja per shkak te detyres" 2009



Më poshtë paraqitet grafiki shpërndarja gjeografike për veprën penale të parashikuar nga neni 239 i Kodit Penal “Fyerja për shkak të detyrës” në dy vite 2008-2009 në rrethe si dhe linja e trendit të kësaj vepre penale në të dy vitet në referencë:

Neni 239 "Fyerja per shkak te detyres" 2008-2009



VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES DHE SIGURISË PUBLIKE

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 72.33 ndërsa për vitin 2009 është 78.71 krime për 100.000 banorë. Tendeca është për rritje, e koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 13,21% (për qind) për vitin 2008 dhe 14,86% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit

total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për vepra penale kundër autoritetit të shtetit:

V.P./ Kushtetues Sigurisë Publike	2008					2009				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 261 Pengimi në ushtrimin e së drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme	7	2	2	8	0	6	2	2	4	1
Neni 263 Organizimi i grumbullimeve e manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 264 Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 266 Thirrja për urrejtje nacionale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 267 Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 268 Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 269 Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 270 Rebelimi i të burgosurve	2	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Neni 271 Disinformimii ekupeve	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0

të urgjencës										
Neni 272 Njoftimi i rremë në organet e rendit	5	4	4	5	4	4	2	2	2	0
Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit	91	45	42	45	46	126	48	43	50	44
Neni 274 Prishja e qetësisë publike	94	56	85	87	50	75	50	65	78	64
Neni 275 Përdor. me keqdashje i thirrj. telefonike	243	34	42	34	17	335	49	53	48	29
Neni 276 Përdorimi pa të drejtë i emblemës së Kryqit të Kuq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 277 Vetëgjyqësia	81	45	60	54	47	118	63	72	77	61
Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit	465	358	391	387	362	466	354	370	387	335
Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta	44	33	37	32	34	40	35	36	37	24
Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjuetisë dhe sportive	50	45	55	49	45	49	48	45	50	42
Neni 281 Shkelja e rregullave mbi lendët helmuese	2	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Neni 282 Shkelja e rregullave mbi lendët plasëse, djegëse dhe radioaktive	8	2	7	4	4	15	14	17	16	12
Neni 282/b Stërvitja për prodhimin dhe përd. e paligjshëm të armëve e lend. të tjera të rrezik.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 283/b Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përd. e drogës	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 284/b Ndhima në zbuli. e krimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/ç Prodhimi, tregëtimi dhe përdorimi i paligjshëm	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

i prekursorëve										
Neni 285/a Përshtatja e lokalit për përdorim droge	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 285/b Hedhja ose braktisja e shiringave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 286 Nxitja për përdorimin e drogës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Neni 286/a Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 288 Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin	5	2	3	2	2	1	0	0	0	0
Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industr. dhe ushqimorë	21	11	17	11	9	16	10	11	12	2
Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	67	8	28	10	9	64	14	19	17	9
Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	851	396	568	401	329	851	390	546	399	335
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi	243	233	250	253	237	335	324	340	351	284
Neni 292 Shkelja e disiplinës së punës në transport	4	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transp.	6	4	8	9	9	8	3	5	4	7
Totali	2293	1278	1599	1391	1205	2514	1406	1626	1532	1251

Nga të dhënat rezultojnë se në vitin 2009 ka një rritje prej 9,63% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë publike, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq me rritje janë procedimet të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 10% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit, rezultojnë nga të dhënat statistikore se ka rritje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 1,68% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezultojnë me rritje të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 10,13% (për qind) në vitin 2009

në krahasim me vitin 2008. Rezulton me rritje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 3,81% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 1990 të pandehur në hetim, ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 1851 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 7,5% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 1532 që do të thotë 10,13% (për qind) më shumë se në vitin 2008 (1391 të pandehur dërguar gjyqit). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 76,98% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 75,14,% (për qind).

Të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 1456 të pandehur. Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezulton rritje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 1405 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 1422 të pandehur meshkuj, pra rezulton me rritje prej 1,2% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. të pandehura femra, gjatë vitit 2009 rezultojnë 34, përkundrejt vitit 2008 me 47 të pandehura femra, që do të thotë ulje prej 27,65% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur të mitur (14-18 vjec) rezulton nga të dhënat statistikore se janë 102 të tillë në vitin 2009; nga të cilët, 98 të pandehur të mitur janë meshkuj, përkundrejt 86 të pandehur të mitur në vitin 2008 meshkuj, të rregjistruar për këtë grup veprash penale gjatë vitit 2008, që do të thotë rritje prej 13,95% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Të pandehur të mitur, femra, për vitin 2009 rezultojnë 4 ndërsa në vitin 2008 rezulton 1, që do të thotë rritje 300% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur të huaj, rezultojnë në vitin 2009 3, përkundrejt 16 në vitin 2008, që do të thotë ulje prej 81,25% (për qind).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 1009 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 3,27% (për qind) në krahasim me vitin 2008; 485 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrejt 514 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje prej 5,64% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008); 63 të pandehur rezultojnë me arsim të lartë në vitin 2009, përkundrejt 60 të tillë në vitin 2008, që do të thotë, një rritje prej 5% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 337 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në rritje prej 10,85% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Nga sektori shtetëror, rezultojnë 25 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në rritje prej 8,69% (për qind) në krahasim me vitin 2008 kur nuk është rregjistruar asnjë i tillë. Në vitin 2009, 1 i pandehur rezulton të jetë “nëpunës i nivelit të lartë”, që do të thotë ulje prej 75% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2009, 3 të pandehur rezultojnë të jenë “funksionar”, që do të thotë rritje në krahasim me vitin 2008, kur nuk është rregjistruar asnjë i tillë. Në vitin 2009 rezultojnë se 4 të pandehur “nëpunës niveli i mesëm”, përkundrejt vitit 2008 kur nuk është rregjistruar asnjë i tillë. Në vitin 2009, 17 të pandehur rezultojnë të jenë “nëpunës i thjeshtë”, që do të thotë rritje prej 6,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në vitin 2009 rezultojnë se 976 të pandehur janë të papunë, pra me rritje prej 8,56% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se 882 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë ulje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 7,64% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 668 prej tyre në komuna, që do të thotë se kemi rritje prej 12,64% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 1502 të pandehur janë të padënuar më parë (që do të thotë rritje prej 1,9% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi. Përsëritës për të njëjtën vepër penale rezultojnë 10 të pandehur gjatë vitit 2009, që do të thotë ulje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Përsëritës për vepra penale të ndryshme rezultojnë 48 të pandehur gjatë vitit 2009, që do të thotë ulje prej 11,11% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të dëmtuar-viktima, rezultojnë nga të dhënat statistikore, për këtë grup veprash penale në total 387, që do të thotë një ulje prej 7,4% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Të dëmtuar-viktima, të rritur mbi 18 vjec, rezultojnë nga të dhënat statistikore 281 meshkuj, që do të thotë ulje prej 11% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe 74 që do të thotë ulje prej 1,36% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Të dëmtuar-viktima, të mitur deri 18 vjec, rezultojnë nga të dhënat statistikore 28 meshkuj, që do të thotë rritje prej 47,36% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe 4 që do të thotë ulje prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me pasojat në dëm të shëndetit, theksojmë se në vitin 2009 janë rregjistruar 244 raste me pasoje vdekjen që do të thotë ulje prej 8,95% (për qind) në krahasim me vitin 2008; plagosje e rëndë, rezultojnë 147 raste, që do të thotë ulje prej 16,47% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe plagosje e lehtë rezultojnë 372 raste, që do të thotë rritje prej 0,54% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “largimi nga vendi i aksidentit”

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”, vihet re tendeca për rritje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 126 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 38,46% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”, në vitin 2009 është 3.94, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 2,87 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 3,96% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 5% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur prej 6,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezulton të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar në masën prej 2,38% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezulton me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 11,11% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është ulur në një masë prej 4,34% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 273 "Largimi nga vendi i aksidentit" 2005-2009




Rezultoni nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka një rritje prej 18,86% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale, në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 55,55 (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi ulje të procedimeve penale të rregjistruara prej 7,14% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 38,46% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në Tiranë janë rregjistruar 64 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 50% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Durrës, janë rregjistruar 22 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 17% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Lezhë, janë rregjistruar 10 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 8% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Shkodër, janë rregjistruar 9 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 7% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Elbasan, janë rregjistruar 6 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 5% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Korçë, janë rregjistruar 4 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 3% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Vlorë, janë rregjistruar 3 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 2% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Berat dhe Kurbin, janë rregjistruar nga 2 procedime penale gjatë vitit 2009, ose nga 2% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Dibër, Krujë, Lushnje dhe Pogradec është rregjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale, ose nga 1% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 273 "Largimi nga vendi i aksidentit"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal "Prishja e qetësisë publike"

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal "Prishja e qetësisë publike", vihet re tendenca për rritje të procedimeve të regjistruara, në vitin 2009, janë regjistruar 75 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë ulje prej 20,21% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 274 i Kodit Penal "Prishja e qetësisë publike", në vitin 2009 është 2,34, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 2,96 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 4% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 2,98% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 10,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e regjistruar në masën prej 23,52% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me ulje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 10,34% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 28% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 274 "Prishja e qetesise publike" 2005-2009



Rezultoni nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka një rritje prej 4% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale, në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 43,13 (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 28,76% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 20,21% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Neni 274 "Prishja e qetesise publike"



Në Tiranë janë rregjistruar 24 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 33% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Berat janë rregjistruar 24 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 24% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Korçë, janë rregjistruar 7 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 9% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Elbasan, janë rregjistruar 6 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 8% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Fier janë rregjistruar 5 procedime penale gjatë vitit 2009, ose 7% (për qind) e procedimeve të rregjistruara në shkallë vendi; në Durrës, janë rregjistruar 4 procedime penale, ose 5% (për

qind) e procedimeve në shkallë vendi; në Lushnje, janë rregjistruar 3 procedime penale, ose 4% (për qind) e procedimeve në shkallë vendi; në Kavajë dhe Pogradec, janë rregjistruar nga 2 procedime penale, ose nga 3% (për qind) e procedimeve në shkallë vendi; në Gjirokastrë, Kukës, Kurbin dhe Lezhë, është rregjistruar nga 1 procedim penale, ose 1% (për qind) e procedimeve në shkallë vendi;

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”


Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 335 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë rritje prej 37,86% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 275 i Kodit Penal “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, në vitin 2009 është 10.48, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 7.66 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 10,59% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 13,32% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur prej 44,11% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar në masën prej 26,19% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 41,17% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 70,58% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:



Rezultojnë nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka një rritje prej 91,11% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 51,74 (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi ulje të procedimeve penale të

rregjistruara prej 6,89% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë veprë penale prej 37,86% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Më poshtë paraqitet grafiksht procedimet e rregjistruara gjatë viteve 2008 dhe 2009 në rrethe të ndryshme të vendit:



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal "Vetëgjyqësia".


Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal "Vetëgjyqësia", vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 118 procedime penale për këtë veprë penale që do të thotë rritje prej 45,67% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 277 i Kodit Penal "Vetëgjyqësia", në vitin 2009 është 3.69, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 2.55 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 3,53% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 4,69% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar në masën prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 42,59% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë veprë penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 29,78% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:



Rezulton nga të dhënat statistikore se, në vitin 2006 ka një rritje prej 14,81% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje prej 17,74 (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 kemi rritje të procedimeve penale të rregjistruara prej 10,95% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale prej 45,67% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Më poshtë paraqitet grafiksht procedimet e rregjistruara gjatë viteve 2008 dhe 2009 në rrethe të ndryshme të vendit:

Neni 277 "Vetëgjyqesia" 2008-2009



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 282 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive”.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 282 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive”, vihet re tendenca për rritje të procedimeve të rregjistruara, në vitin 2009, janë rregjistruar 15 procedime penale për këtë vepër penale që do të thotë rritje prej 87,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 282 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive”, në vitin 2009 është 0,46, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0,25 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 0,34% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 0,59% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur prej 600% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar në masën prej 142,85% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 300% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 200% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2005-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:

Neni 282 "Shkelja e rregullave mbi lëndet plasese, djegese dhe radioaktive"
2005-2009



Rezultoni nga të dhënat statistikore se, në vitin 2005 nuk është rregjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në vitin 2006 është rregjistruar 1 procedim penal; në vitin 2007 janë rregjistruar 3 procedime penale; në vitin 2008 janë rregjistruar 8 procedime penale dhe në vitin 2009 janë rregjistruar 15 procedime penale për këtë veprë penale.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, nga të dhënat statistikore, rezultoni se në Tiranë janë rregjistruar 8 procedime penale; në Korçë dhe Lezhë janë rregjistruar nga 2 procedime penale për këtë veprë penale dhe në Berat, Kurbin dhe Shkodër është rregjistruar nga 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 282 "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive" gjatë vitit 2009.

Në këtë grup veprash penale neni 290 "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" është rregjistruar numër i njëjtë procedimesh penale në të dy vitet 2008 dhe 2009, nga 851 procedime penale. Është veprë penale me peshë specifike të lartë.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 290 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", në vitin 2009 është 26.84, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 26,64 krime për 100.000 banorë.


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 37.11% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 33,85% (për qind) në vitin 2009.

Dinamika e kësaj veprë penale në vitet 2004-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:




Vihet re se në vitin 2005 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale me 3.2 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka rritje 9.5 për qind të procedimeve penale të rregjistruara në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje me 34.7 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale; në vitin 2008 ka rritje të lehte me 0.1 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe në vitin 2009 jemi në të njëjtin nivel sikurse edhe në vitin 2008.

Më poshtë paraqitet grafikisht procedimet e rregjistruara në të gjithë republikën në të dy vitet 2008 dhe 2009:



Më poshtë paraqitet grafiki shpërndarja gjeografike për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” për vitin 2009, sipas rretheve dhe përqindjet përkatëse:

Neni 290 "Shkelja e rregullave te qarkullimit rrugor" 2009



Në lidhje me “të dëmtuarit-viktima” për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, rezultojnë nga të dhënat statistikore se:

Të mitur, të dëmtuar viktimë rezultojnë të jenë 15, që do të thotë ulje prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga këta, meshkuj rezultojnë të jenë 11, që do të thotë ulje prej 31,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008; femra, rezultojnë të jenë , që do të thotë ulje prej 55,55% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të rritur, në total rezultojnë në vitin 2009, 260, që do të thotë ulje prej 17,46% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Nga këta, 207 rezultojnë meshkuj, që do të thotë ulje prej 17,85 (për qind) dhe 53 femra, që do të thotë ulje prej 15,87% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Pasojat në dëm të shëndetit, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 janë 207 raste me pasojë vdekje, që do të thotë ulje prej 5,47% (për qind) në krahasim me vitin 2008; me pasojë plagosje e rëndë rezultojnë 132 raste, që do të thotë ulje prej 12,58% (për qind) dhe me pasojë “plagosje e lehtë” rezultojnë 258 raste, që do të thotë ulje prej 12,54% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Në këtë grup veprash penale për nenin 291 “Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi” janë rregjistruar 335 procedime penale, që do të thotë rritje prej 37,86% (për qind) në krahasim me vitin 2008

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi”, në vitin 2009 është 10,48, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 7,66 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 10,59% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 13,32% (për qind) në vitin 2009.


Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur prej 39% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e rregjistruar në masën prej 36% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultojnë me rritje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 38,73% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është rritur në një masë prej 19,83% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2004-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:




Edhe në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi” vihet re një tendencë në rritje e procedimeve të rregjistruara pranë organit të prokurorisë. Kështu, sipas të dhënave statistikore vihet re një rritje e procedimeve në vitin 2005 prej 2.4 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 23 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka përsëri një rritje të ndjeshme prej 84,2 për qind në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka përsëri një rritje prej 23,4 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë veprë penale, në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsëri rritje prej 37,86% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Më poshtë paraqitet grafikisht procedimet e rregjistruara për këtë veprë penale në rrethe në vitet 2008-2009:



Grafikisht, paraqitet më poshtë shpërndarja gjeografike për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi” për vitin 2009 në të gjithë rrethet si dhe përqindjet përkatëse:

Neni 291 "Drejtimi i automjetit ne gjendje te dehur apo pa deshmi" 2009



VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHTETËRORE

Koefiçenti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2008 ishte 12.93 ndërsa për vitin 2009 është 4.6 krime për 100.000 banorë. Tendeca është për rritje, e koefiçentit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë është 2,36% (për qind) për vitin 2008 dhe 0,86% (për qind) për vitin 2009 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për vepra penale kundër autoritetit të shtetit:

V.P / Sekretit dhe kufijve shteterore	2008					2009				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Për gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd për gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand për gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 294 Tregtimi I sekretit shtetëror nga përsone që I është besuar	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 295 Tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0

sekrete										
Neni 296 Humbja e dokumenteve sekrete	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Neni 297 Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror	185	172	211	211	195	34	36	33	46	71
Neni 298 Ndhima për kalim të paligjshëm të kufijve	221	112	206	170	153	111	102	107	149	183
Neni 299 Shkelja e rregullave mbi fluturimet	1	1	1	1	0	0	0	0	0	2
Totali	410	285	418	382	348	147	139	140	196	257

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2009 ka një ulje prej 64,14% (për qind) të procedimeve penale të rregjistruara për veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, në krahasim me vitin 2008. Ndërkaq me ulje janë procedimet të cilat janë dërguar në gjykatë në vitin 2009 prej 51,2% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me të pandehurit, rezulton nga të dhënat statistikore se ka rritje të të pandehurve të rregjistruar në vitin 2009 prej 66,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezulton me ulje të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 48,69% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Rezulton me ulje edhe të pandehurit e dënuar nga gjykata në vitin 2009 prej 26,14% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008;

TË PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2009 në total janë 237 të pandehur në hetim, ndërsa në vitin 2008 në total kanë qenë 484 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 51% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se numri i të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2009 është 196 që do të thotë 48,69% (për qind) më pak se në vitin 2008 (382 të pandehur dërguar gjyqit). Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim në vitin 2009 është 82,7% (për qind) ndërsa në vitin 2008 ky tregues ishte 78,92% (për qind).

Të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) rezultojnë 211 të pandehur, që do të thotë ulje prej 49,4% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2008 rezulton ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2009. Kështu, në vitin 2008 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 404 të pandehur ndërsa në vitin 2009 rezultojnë të jetë 205 të pandehur meshkuj, pra rezulton me ulje prej 49,25% (për qind) e numrit të të pandehurve meshkuj në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Të pandehura femra, gjatë vitit 2009 rezultojnë 6, përkundrajt vitit 2008 me 13 të pandehura femra, që do të thotë ulje prej 53,84% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur të mitur (14-18 vjec) rezulton nga të dhënat statistikore se janë 8 (meshkuj) të tillë në vitin 2009, që do të thotë ulje prej 75% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur të huaj, rezultojnë 11 të pandehur në vitin 2009, përkundrajt 9 në vitin 2008, që do të thotë rritje prej 22,22% (për qind).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 153 të pandehur janë me arsim deri 9-vjecar në vitin 2009, që do të thotë ulje prej 53,49% (për qind) në krahasim me vitin 2008; 64 të pandehur rezultojnë të jenë me arsim të mesëm në vitin 2009 përkundrajt 117 të pandehurve me arsim të mesëm në vitin 2008 (tregues që rezulton me ulje prej 45,29% (për qind), në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008).

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se, nga sektori privat rezultojnë 32 të pandehur që do të thotë se ky tregues në vitin 2009 dhe është në rritje prej 6,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në vitin 2009 rezultojnë se 183 të pandehur janë të papunë, pra me ulje prej 54% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Rezulton se 105 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, që do të thotë ulje e këtij treguesi për vitin 2009 prej 56,61% (për qind) në krahasim me vitin 2008, ndërsa 114 prej tyre në komuna, që do të thotë se kemi ulje prej 40,93% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, 209 të pandehur janë të padënuar më parë (që do të thotë ulje prej 51,5% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 e këtij treguesi. Përsëritës për të njëjtën veprë penale rezultojnë nuk rezulton asnjë i pandehur gjatë vitit 2009, në krahasim me vitin 2008 kur rezultojnë 6 të tillë. Përsëritës për vepra penale të ndryshme rezultojnë 10 të pandehur gjatë vitit 2009, që do të thotë ulje prej 16,66% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të dëmtuar-viktima, rezultojnë nga të dhënat statistikore, për këtë grup veprash penale në total 387, që do të thotë një ulje prej 7,4% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Të dëmtuar-viktima, të rritur mbi 18 vjec, rezultojnë nga të dhënat statistikore 281 meshkuj, që do të thotë ulje prej 11% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe 74 që do të thotë ulje prej 1,36% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Të dëmtuar-viktima, të mitur deri 18 vjec, rezultojnë nga të dhënat statistikore 28 meshkuj, që do të thotë rritje prej 47,36% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe 4 që do të thotë ulje prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me pasojat në dëm të shëndetit, theksojmë se në vitin 2009 janë rregjistruar 244 raste me pasojë vdekjen që do të thotë ulje prej 8,95% (për qind) në krahasim me vitin 2008; plagosje e rëndë, rezultojnë 147 raste, që do të thotë ulje prej 16,47% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe plagosje e lehtë rezultojnë 372 raste, që do të thotë rritje prej 0,54% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” janë rregjistruar 34 procedime penale, që do të thotë ulje prej 81,62% (për qind) në krahasim me vitin 2008

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, në vitin 2009 është 1, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 5.8 krime për 100.000 banorë.


Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 45,12% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 23,12% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 79% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezulton të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar në masën prej 84,36% (për qind) në

krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezultoi me ulje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 78,19% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultoi se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është ulur në një masë prej 63,58% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2004-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:


Neni 297 "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror" 2005-2009



Kështu, sipas të dhënave statistikore vihet re një ulje e procedimeve në vitin 2006 prej 16,52% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një ulje prej 13,54% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 122,89% (për qind) për qind në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje prej 81,62 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2008.

Më poshtë paraqitet grafiksht shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të rregjistruara në rrethe të ndryshme të vendit gjatë vitit 2009 si dhe përqindjet përkatëse:

Neni 297 "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror"




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufijve” janë rregjistruar 111 procedime penale, që do të thotë ulje prej 49,77% (për qind) në krahasim me vitin 2008

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar neni 298 i Kodit Penal “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufirijve”, në vitin 2009 është 3.47, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 6.97 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë ka qenë 53.9% (për qind) në vitin 2008 dhe është bërë 75.5% (për qind) në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur prej 8,92% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 me ulje rezulton të jetë edhe treguesi që ka të bëjë më të pandehurit e rregjistruar në masën prej 48% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 rezulton me ulje treguesi në lidhje me të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 12,35% (për qind) në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë vepër penale, në vitin 2009 është ulur në një masë prej 19,6% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Dinamika e kësaj vepre penale në vitet 2004-2009 paraqitet në grafikun e mëposhtëm, procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë:




Nga të dhënat statistikore vihet re një rritje e procedimeve në vitin 2006 prej 25,39% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rritje prej 31% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2008 ka një rritje prej 6,76% (për qind) për qind në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje prej 49,77 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2008.

Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndhimja për kalim të paligjshëm të kufijve” gjatë vitit 2009 sipas rretheve dhe përqindjet përkatëse:

Neni 298 "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve"




Më poshtë paraqitet grafikisht procedimet penale të regjistruara gjatë viteve 2008-2009 në rrethet të vendit për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”:



Neni 90 i Ligjit “për bankat” rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2008 ka uljje të procedimeve penale të regjistruar për këtë veprë penale prej 29,8% (për qind) në krahasim

me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka përsërim ulje prej 52% 9për qind) të procedimeve penale të rregjistruar për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2008.


Më poshtë paraqitet grafiksht shpërndarja gjeografike për këtë vepër penale për vitet 2008-2009:



TË DHËNAT PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2009

Grafiku i mëposhtem paraqet të dhëna për të pandehur në hetim në pesë vitet e fundit (2005 – 2009). Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur të cilët janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të rregjistruar nga organi i prokurorisë dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë.

TE DHENA PER TE PANDEHURIT 2009



Sikurse shihet nga grafiku i mësipërm, të dhënat tregojnë për një rritje në përgjithësi të numrit të pandehurve në hetim nga viti në vit dhe me një ulje të lehtë në vitin 2009.

Në lidhje me të pandehurit e rregjistruar, nga të dhënat statistikore rezultojnë se dinamika e këtij treguesi në pesë vite është si më poshtë:

Në vitin 2006 janë rregjistruar 8031 të pandehur, që do të thotë 7,62% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 janë rregjistruar 9015 të pandehur, që do të thotë 12,25% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 janë rregjistruar 9548 të pandehur, që do të thotë 5,9% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 janë rregjistruar 8130 të pandehur, që do të thotë ulje prej 14,85% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Të pandehur të mbartur, nga viti në vit, duke marrë në referencë vitet 2005-2009 rezultojnë se:

Në vitin 2006 janë mbartur 1920 të pandehur, që do të thotë 3,95% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 janë rregjistruar 1908 të pandehur, që do të thotë 0,625% (për qind) më pak se në vitin 2006; në vitin 2008 janë mbartur 2230 të pandehur, që do të thotë 16,87% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 janë mbartur 2962 të pandehur, që do të thotë rritje prej 32,82% (për qind) në krahasim me vitin 2008.


Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezultojnë se:

Në vitin 2006 janë rifilluar hetimet për 146 të pandehur, që do të thotë 12,3% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 janë rifilluar hetimet për 237 të pandehur, që do të thotë 62,32% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 janë rifilluar hetimet për 136 të pandehur, që do të thotë 42,6% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 janë rifilluar

hetimet për 152 të pandehur, që do të thotë rritje prej 11,76% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

në vitin 2006 është ngritur akuza në gjykatë për 7529 të pandehur ose 7% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 është ngritur akuza në gjykatë për 7719 të pandehur ose 2,52% më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 është ngritur akuzë në gjykatë për 8726 të pandehur ose 13% (për qind) më shumë se në vitin 2007 dhe në vitin 2009 është ngritur akuzë në gjykatë për 8352 të pandehur ose 4,28% (për qind) më pak se në vitin 2008.

Më poshtë paraqiten grafikisht të dhëna mbi të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, të pandehur të gjykuar dhe të dënuar, në pesë vitet e fundit (2005-2009):



Në lidhje me të pandehurit të gjykuar në raport me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rezulton nga të dhënat statistikore se:

Në vitin 2005, 90,85% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2006, 93% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2007, 87,53% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2008, 86% e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar dhe në vitin 2009, 89,2% e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar.

Në lidhje me të pandehurit e dënuar të dhënat rezultojnë si vijon: në vitin 2005 janë dënuar 6063 të pandehur ose 86,19% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit; në vitin 2006 janë dënuar 6795 të pandehur ose 90% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit; në vitin 2007 janë dënuar 5859 të pandehur ose 75,9% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit; në vitin 2008 janë dënuar 7278 të pandehur ose 83,4% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2009 janë dënuar 7172 të pandehur ose 85,87% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit.

Rezulton se treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve ka ardhur në rritje, kështu: për vitin 2005 rreth 94,86% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2006 rreth 96,94% (për qind) e

përsone të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2007 rreth 86,71% (për qind) e përsone të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2008 rreth 96,76% (për qind) e përsone të gjykuar janë shpallur fajtoë nga gjykata dhe në vitin 2009 rreth 96,29% (për qind) e përsone të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata.


Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorës në vite, në ngritjen e akuzës në fazën e hetimit paraprak rezulton se: në vitin 2005 rreth 74,52 % (për qind) e përsone për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2006 rreth 74,56 % (për qind) e përsone për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2007 rreth 69,16 % (për qind) e përsone për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2008 rreth 73,24 % (për qind) e përsone për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2009 rreth 74,27 % (për qind) e përsone për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim.

GJINIA E TË PANDEHURVE

Rezultoni nga të dhënat statistikore për të pandehurit meshkuj se: në vitin 2006 janë 7721 të pandehur meshkuj, ose rritje prej 7,79% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 janë 8489 të pandehur ose rritje prej 9,94% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë 8870 të pandehur ose rritje prej 4,48% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 janë 6919 të pandehur ose ulje prej 21,99% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Për të pandehurit femra rezulton nga të dhënat statistikore se: në vitin 2006 janë 455 të pandehur femra, ose ulje prej 7,7% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 janë 523 të pandehura ose rritje prej 14,94% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë 457 të pandehura ose ulje prej 12,6% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 janë 349 të pandehura ose ulje prej 23,63% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




TË PANDEHUR TË MITUR.

Në lidhje me të pandehurit të mitur, nga të dhënat statistikore rezultojnë se: në vitin 2006 rezultojnë 431 të mitur të pandehur ose 27,89% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 rezultojnë 580 të mitur të pandehur ose 34,57% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 889 të mitur të pandehur ose 53,27% (për qind) më shumë se në vitin 2007 dhe në vitin 2009 rezultojnë 665 të mitur të pandehur ose 25,19% (për qind) më pak se në vitin 2008;

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

TE PANDEHUR TE MITUR 2005-2009



në lidhje me të pandehurit të mitur, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2008 nga 889 të pandehur, 871 janë meshkuj dhe 18 janë femra. në vitin 2009, nga 665 të pandehur të mitur, 636 janë meshkuj, që do të thotë ulje prej 26,98% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe 29 janë femra, që do të thotë rritje prej 61,11% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Nga të dhënat e vitit 2008 rezultojnë se janë marrë si të pandehur edhe 156 shtetas të huaj dhe në vitin 2009 janë marrë të pandehur 119 shtetas të huaj, që do të thotë ulje prej 23,71% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me arsimimin e të pandehurve, nga të dhënat statistikore vihet re se:


Me arsim deri 9-vjecar, rezultojnë në vitin 2006, 5130 të pandehur ose 7,4% (për qind) më shumë në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 rezultojnë 5338 të pandehur ose 4% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 5942 të pandehur ose 11,31% (për qind) më shumë se në vitin 2007 dhe në vitin 2009 rezultojnë 5123 të pandehur ose 13% (për qind) më pak se në vitin 2008.

Me arsim të mesëm, rezultojnë 2643 të pandehur në vitin 2006 ose 8,8% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007, rezultojnë 3140 të pandehur ose 18,8% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 2965 të pandehur ose 5,57% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 2416 të pandehur ose 18,5% (për qind) më shumë se në vitin 2008.

Me arsim të lartë, rezultojnë 360 të pandehur në vitin 2006 ose 2% (për qind) më pak se në vitin 2005; në vitin 2007, rezultojnë 489 të pandehur ose 35,83% (për qind) më shumë se në

vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 431 të pandehur ose 11,8% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 397 të pandehur ose 7,88% (për qind) më pak se në vitin 2008.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Përsa i takon gjëndjes shoqërore të të pandehurve, për të pandehur të cilët janë të punësuar në sektorin shtetëror, rezulton se në vitin 2009, ka një rënie prej 58,59% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Rezulton nga të dhënat statistikore se të pandehurit të cilët janë të punësuar në sektorin privat në vitin 2009 ka rritje prej 8,45% në krahasim me vitin 2008. Të pandehur të papunë, rezultojnë nga të dhënat statistikore se janë gjithsej 4888 të pandehur, që do të thotë ulje prej 6,36% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun më poshtë:


TE DHENA MBI GJENDJEN SHOQERORE TE TE PANDEHURVE 2005-2009



Në lidhje me Vendbanimin e personave të cilet janë marrë të pandehur, theksojmë nga të dhënat statistikore rezultojn se: të pandehur me vendbanim në qytet rezultojnë në vitin 2009 gjithsej 4634 të pandehur, që do të thotë ulje prej 18% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në lidhje me të pandehurit me vendbanim në komunë, rezultojn nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 gjithsej 3247 të pandehur, që do të thotë ulje prej 9,22% (për qind) në krahasim me vitin 2008. Pavarësisht tendecave të lehta në ulje për të dy kategoritë, kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në zonat urbane sesa në zonat rurale.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


TE DHENA MBI VENDBANIMIN E TE PANDEHURVE 2008-2009



Përsa i takon gjëndjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2009 rezultojnë të pandehur të cilët janë përsëritës për të njëjtën veprë penale 174 persona që do të thotë ulje prej 20,54% (për qind) në krahasim me vitin 2008; përsëritës për vepra penale të ndryshme rezultojnë 304 persona, që do të thotë 13,63% (për qind) më pak në krahasim me vitin 2008 dhe të pandehur të padënuar më parë, rezultojnë 7407 persona, që do të thotë ulje prej 11,99% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

TE DHENA MBI GJENDJEN GJYQESORE TE TE PANDEHURVE 2008-2009




Në lidhje me pasojat e veprave penale, në dëm të shëndetit, nga të dhënat statistikore rezultojnë se ka një rënie të pasojës me vdekje nga veprat penale gjatë vitit 2009 prej 17,55% (për qind) në krahasim me vitin 2008 (540 raste); me ulje, rezulton pasoja nga veprat penale “plagosje e rëndë” dhe ulja është prej 16,61% (për qind) më shumë se në vitin 2008 dhe pasojë e veprës penale “plagosje e lehtë” rezulton me ulje prej 13,83% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në shifrat e mësipërme përfshihen pasojat në dëm të jetës dhe të shëndetit të personave, për cdo fakt të dyshuar kriminal të hetuar, pavarësisht nga mënyra e përfundimit të procedimit rreth tij.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

TE DHENAT MBI PASOJAT NE DEMTESHENDETTI 2008-2009



Të dhëna mbi viktimat.

Gjatë vitit 2009, rezultojnë të demtuar-viktima të veprave penale 941 persona, nga të cilët, të demtuar-viktima të mitur janë 61 meshkuj dhe 16 femra; të rritur rezultojnë nga të dhënat statistikore, 722 meshkuj dhe 142 femra.

Ne total do të thotë ulje e viktimave në vitin 2009 prej 21,51% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

NË LIDHJE ME DINAMIKËN E VEPRAVE PENALE TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR.8003, DATË 28.9.1995(I NDRYSHUAR) “KODI PENAL USHTARAK”

Nga të dhënat statistikore, vihet re se në lidhje me veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak, vihet re një tendencë për ulje të ndjeshme për procedimet e rregjistruara në lidhje me veprat penale të parashikuara nga Kreu i Parë i tij “Vepra penale në fushën e mbrojtjes” ku vihet re një ulje e ndjeshme e procedimeve penale të rregjistruara në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008, prej 98,33% (për qind).


Me ulje rezultojnë edhe procedimet penale të rregjistruara sipas Kreut të Tretë të Kodit Penal Ushtarak “Shmangia nga shërbimi ushtarak”. Rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2008, për këtë grup veprash penale janë rregjistruar 592 procedime penale, ndërsa në vitin 2009 janë rregjistruar 384 procedime penale, që do të thotë ulje prej 35,13% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

Gjithashtu, me ulje të ndjeshme rezultojnë edhe procedimet penale të rregjistruara për veprat penale të parashikuara nga Kreu i Pestë i Kodit Penal Ushtarak “Vjedhje Shpërdorime, Falsifikime”. Kështu, në vitin 2008 për këtë grup veprash penale janë rregjistruar 27 procedime penale ndërsa në vitin 2009 janë rregjistruar 8 procedime penale, që do të thotë një ulje prej 70.37% (për qind) në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008.

TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KERKUARA NGA PROKURORËT

Të dhënat statistikore tregojnë për ulje të denimeve me gjobë (kërkesa të prokurorëve) gjatë vitit 2009 dhe ulja është prej 3,35% (për qind) në krahasim me vitin 2008..

Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e tij në pesë vitet e fundit (2005-2009):




Vihet re se në vitin 2006 ka një rritje prej 13,26% (për qind) të kërtimeve të prokurorëve për dënimin me gjobe, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 23% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 53,92% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 3,35% (për qind), kërtime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2006 ka një rritje prej 11,03% (për qind) të vendimeve të gjykatës për dënimin me gjobe, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 52,89% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 158,75%

(për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 2,4% (për qind), vendime të gjykatës për këtë lloj dënimi.


Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë në pesë vitet e fundit të masës së dënimit me burgim në minimumin e parashikuar nga ligji:



Vihet re se në vitin 2006 ka një rritje prej 4,9% (për qind) të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim në minimum, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 13,54% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 31,81% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 4,32% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2006 ka një rritje prej 12,68% (për qind) të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në minimum, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 19,85% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 29,65% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 2,1% (për qind), të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.


Në pesë vite, kërkimet e prokurorëve dhe vendimet e gjykatës për masë dënimi mesatar, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Vihet re se në vitin 2006 ka një rritje prej 16,77% (për qind) të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim mesatar, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 1,95% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 1,1% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 2,75% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2006 ka një rritje prej 24,27% (për qind) të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim mesatar, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 2,9% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje të lehtë prej 0,93% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një ulje prej 4,79% (për qind), vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet masën e dënimin me burgim në maksimum gjatë pesë viteve të fundit:




Vihet re se në vitin 2006 ka një rritje prej 2,76% (për qind) të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim në maksimum, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij

treguesi prej 8,75% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 24,35% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,87% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin 2006 ka një rritje prej 14,76% (për qind) të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 12,44% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 30,33% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,76% (për qind), vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.

Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji në pesë vitet e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Ecuria në pese vitet fundit (2004-2008) paraqitet e tillë që: në vitin 2006 ka një ulje prej 71,42% (për qind) të kërkimeve të prokurorëve për ulje të dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 10% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një rritje prej 3,5 herë për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2008.

Ecuria në pese vitet fundit (2004-2008) paraqitet e tillë që: në vitin 2006 ka një ulje prej 75,75% (për qind) të kërkimeve të prokurorëve për ulje të dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të këtij treguesi prej 156,25% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 39,02% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një rritje prej 36% (për qind) për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venia në provë” si kërkime të prokurorit, në pesë vitet e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venia në provë 2005-2009




Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2006 ka një rritje prej 14,42% (për qind) të kërtimeve të prokurorëve për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venia në provë”, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 1,29% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 0,65% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 0,97% (për qind), kërtime të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venia në provë” në parashikim të nenit 59 të Kodit Penal.

Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2006 ka një rritje prej 11,13% (për qind) të vendimeve të gjykatës për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venia në provë”, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 13,64% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 18% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 1,02% (për qind), kërtime të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venia në provë” në parashikim të nenit 59 të Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e dënimit me burgim të përjetshëm për vitet 2005-2009:

Burgim i perjetshem 2005-2009



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2006 ka ulje të kërkimeve të prokurorit për këtë masë dënimi prej 23,8% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 56,25% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 214,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një ulje prej 31,81% (për qind), kërkime të prokurorit për masën e dënimit, burgim i përjetshëm.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2006 ka ulje të vendimeve të gjykatës për këtë masë dënimi prej 18,75% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 61,53% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 160% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka një ulje prej 61,53% (për qind), kërkime të prokurorit për masën e dënimit, burgim i përjetshëm.

TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2009

Pjesë shumë e rëndësishme e punës së organit të prokurorisë janë edhe marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja. Në vijim paraqesim të dhëna statistikore për:

në lidhje me ekstradimet, nga të dhënat statistikore rezulton se në gjatë vitit 2009 janë ekstraduar fizikisht në Shqipëri 94 persona, shifër e cila përbën edhe numrin më të madh të të ekstraduarve ndër vite. Ndërsa në vitin 2008 janë bërë në total 87 ekstradime fizike, që do të thotë se në vitin 2009 ka një rritje prej 8% (për qind) të të ekstraduarve fizikisht në krahasim me vitin 2008. Këto ekstradime janë 50 persona të ekstraduar nga Italia, 17 nga Greqia, 4 Belgjika, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj. Sikurse vihet re edhe nga të dhënat statistikore rezulton se numri më i madh i personave të ekstraduar gjatë vitit 2009 rezulton të jetë me shtete fqinje si Italia dhe Greqia ku edhe numri i shtetasve shqiptarë është edhe më i lartë. Por vihen re edhe raste me shtete si Kanada, Gjermani, Holandë, Spanjë etj. E njëjta tendencë vihet re edhe gjatë vitit 2008 ku shumica e ekstradimeve është me vendet fqinje si Italia (37 të ekstraduar gjatë viti 2008) dhe Greqia (23 të ekstraduar) etj.

Në lidhje me kërkesat për ekstradime, nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2009 janë në total 105 kërkesa të dërguara në Ministrinë e Drejtësisë të cilat sipas autoriteteve të huaja janë: Italia 48 kërkesa, Greqia 25 kërkesa, Mbretëria e Bashkuar 12 kërkesa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës 6 kërkesa, etj.

Në vitin 2008 rezulton se numri i kërkesave të dorëzuara në Ministrinë e Drejtësisë ka qenë 149 kërkesa që përbën numrin më të madh ndër vite. Konkretisht përmendim, 59 kërkesa në Itali, 27 kërkesa në Greqi, 10 kërkesa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 9 kërkesa në Gjermani, 8 kërkesa në Mbretërinë e Bashkuar, Kanada 6 kërkesa, Holanda 5 kërkesa, Francë 3 kërkesa etj.

Për cdo rast për të cilin Prokuroria e Përgjithshme është njoftuar nga ZQK INTERPOL TIRANA për lokalizim apo arrestim të personave për qëllim ekstradimi, është paraqitur brenda afatit ligjor, kërkesë për ekstradim nga prokuroria në Ministrinë e Drejtësisë.

Në përmbledhje, rezulton se gjatë vitit 2009 ka ulje të numrit të arrestimeve apo lokalizimeve për qëllime ekstradimi dhe për pasojë ulje të kërkesave për ekstradim, në krahasim me vitin 2008.

Përsa i takon ekstradimeve nga Shqipëria, gjatë vitit 2009 janë realizuar 7 ekstradime fizike nga Shqipëria për jashtë shtetit dhe konkretisht:

4 shtetas shqiptarë ekstraduar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës;

3 shtetas të huaj ekstraduar për në Maqedoni, Kinë dhe Bullgari.

Gjatë vitit 2008, janë realizuar në total 3 ekstradime, nga 1 shtetas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Maqedoni dhe Zvicër.

E përmbledhur rezulton nga të dhënat statistikore se ka një rritje gjatë vitit 2009 të trajtimit të këtyre rasteve prej 133,33% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Në lidhje me kërkesat për ekstradim nga autoritetet e huaja për jashtë shtetit, gjatë vitit 2009 rezulton nga të dhënat statistikore se në total janë bërë 5 kërkesa (Shtetet e Bashkuara 3 kërkesa, Kina dhe Maqedonia nga 1 kërkesë), kundrejt po 5 kërkesave gjatë vitit 2008 (3 kërkesa për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga 1 kërkesë për Bullgarinë dhe Zvicrën). Pra, sikurse vihet re edhe nga të dhënat statistikore, jemi në të njëjtat shifra gjatë vitit 2008 sikurse dhe në vitin 2009 për këtë tregues.

Në lidhje me transferimin e personave të dënuar nga gjykatat shqiptare për jashtë shtetit, gjatë vitit 2009 ka patur 2 persona të transferuar (Greqi dhe Maqedoni) përkundrejt vitit 2008 që ka patur 3 raste (2 me Italinë dhe 1 me Greqinë).

Gjatë vitit 2009 janë transferuar nga jashtë shtetit në Shqipëri për të vuajtur dënimin në burgjet shqiptare 2 persona të dënuar. E njëjta shifër është edhe për vitin 2008. Gjatë vitit 2008 janë përcjellur nga Ministria e Drejtësisë 50 kërkesa për njohje vendimesh penale me efekt transferimi të dënuarve nga burgjet italiane. Pas njohjes së këtyre vendimeve, gjatë vitit 2009 është konstatuar se personat e dënuar i kishin përfunduar vuajtjen e dënimit, pasi kërkesat në Ministrinë e Drejtësisë ishin bërë kryesisht në vitin 2000-2001.

Lidhur me fluksin e letërraportimeve, kemi pasur 1086 nga jashtë shtetit dhe për jashtë shtetit gjatë vitit 2008 dhe 1050 për vitin 2009.

Në vitin 2009 është kërkuar njohja e vendimeve penale të huaja për 54 shtetas shqiptarë nga të cilët 19 nga autoritetet italiane dhe të shoqëruara me kërkesën për arrestim provizor. Pjesa tjetër e kërkesave për njohje janë përgjithësisht nga vendet fqinje si Kosova dhe Maqedonia dhe kanë të bëjnë kryesisht me dënime me gjoba të ulta për kalim të paligshëm të kufirit.

Gjatë vitit 2008 janë paraqitur 50 kërkesa për njohje nga autoritetet e huaja, nga të cilat 25 kërkesa nga autoritetet italiane dhe të shoqëruara me kërkesën për arrestim provizor.

Në vitin 2009 kemi 71 raste të komisioneve rogatore dhe takimeve info-opëratve me partnerët ndërkombëtarë, nga 48 të tilla në vitin 2008. Vlen të përmendim këtu vecanërisht bashkëpunimin me autoritetet italiane, britanike, belge, franceze, holandeze e gjermane. Vlen të theksohet një qasje e re e bashkëpunimit me autoritetet e huaja, ajo e komisioneve rogatore apo takimeve info-opëratve të kërkuara nga autoritetet shqiptare dhe të zhvilluara jashtë Shqipërisë, e cila megjithëse është në fillimet e saj ka rezultuar e sukseshme. Kjo eksperiencë e re është shtrirë kryesisht në hetimin e çështjeve që lidhen me trafiket dhe krimin e organizuar.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm dhe rezultativ i bashkëpunimit me autoritetet e huaja ka qënë trajtimi i rasteve të trafikimit të makinave të vjedhura, një problem që ka qënë i vazhdueshëm, serioz, me shtrirje të gjërë dhe me efekte në marrëdhëniet me autoritetet e huaja. Falë këtij bashkëpunimi, gjatë vitit 2009 është arritur t'u kthehen pronarëve të ligjshëm në shtetet e huaja 40 automjete, një shifër ndjeshëm e lartë krahasuar me vitet e kaluara. Vlen të përmendim këtu bashkëpunimin me autoritetet italiane, franceze, vendet nordike, gjermane, britanike etj.

Trafiku i mjeteve motorike vazhdon të ngelet problem shqetësues për agjencitë e specializuara të zbatimit të ligjit në Shqipëri dhe autoritetet e huaja, vecanërisht në zbulimin dhe goditjen e autorëve të këtij fenomeni transnacional.

Gjatë vitit 2009, kemi hasur problematika përsa i takon Ligjit të ri për bashkëpunimin ndërkombëtar me autoritetet e huaja, i cili detyron prokurorinë për përkthimin e letërkërkesave. Kjo gjë, nuk është shoqëruar me ndryshime në staf apo në buxhet në mënyrë që të përballohet kjo ngarkesë dhe t'i përgjigjemi këtij detyrimi duke sjellë vështirësi serioze të punës dhe të bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

Në lidhje me njohjet e vendimeve penale të huaja, vihet re një tendencë e gjykatave për të ulur ndjeshëm dënimet e dhëna nga gjykata të huaja; së dyti, kemi raste kur arrestohen personat dhe procesi i njohjes së vendimit penal të huaj deri në marrjen e vendimit formë të prerë zgjat me tepër se 6 muaj. Kjo gjë ka sjellë si pasojë ndryshimin e masës arrest në burg ndaj personit, duke bërë më pas të pamundur ekzekutimin e vendimit kur ky vendim ka marrë formë të prerë pasi personat i janë fshehur drejtësisë; dhe së fundi, kemi raste kur gjykatat kanë rrëzuar kërkesat e prokurorit për njohje.

Mungesa e marrëveshjeve dypalëshe për lejimin e ekstradimit të shtetasve shqiptar jashtë vendit si dhe pamundësia e përdorimit të instrumentave lehtësues të bashkëpunimit ndërkombëtar si Urdhëri i Arrestit European, ka sjellë vështirësi lidhur me ekzekutimin e urdhërave të arresteve ndërkombëtare të lëshuara nga vende të ndryshme ndaj shtetasve shqiptare. Kjo, sidomos në kushtet kur transferimi i procedimit dhe kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj janë të drejta ekskluzive të vendit që procedon apo që ka dhënë vendimin e formës së prerë.

Nga ana tjetër vështirësi të madhe paraqet hetimi i këtyre personave nga prokuroria shqiptare, kjo pasi ngjarjet, dëshmitë, provat dhe gjithçka lidhet me ngjarjen dhe personat gjenden jashtë territorit të Shqipërisë, shtuar këtu edhe koston e jashtëzakonshme dhe të papërballueshme që kanë këto lloj hetimesh. Kjo problematikë është vecanërisht shqetësuese me Italinë edhe për shkak të afërsisë gjeografike dhe numrit të konsiderueshëm të komunitetit shqiptar i cili jeton në Itali por që merr një zgjidhje përfundimtare me ratifikimin nga pala italiane e marrëveshjes për ekstradimin, e miratuar dhe ratifikuar prej vitesh nga pala shqiptare.

PJESA E TRETË

ANALIZË E GRUP TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË

I. Arritjet në përmbushjen e angazhimeve për prioritetet në luftën kundër kriminalitetit.

Në vitin 2009, prioritet tona në luftën kundër kriminalitetit kanë qenë goditja e veprimtarisë së krimit të organizuar dhe terrorizmit, trafikeve të paligjshme, korrupsionit, krimit në detyrë, krimit financiar dhe pastrimit të parave.

Në përmbushjen e këtij angazhimi, jemi fokusuar në rritjen e efektivitetit, nëpërmjet rritjes së cilësisë së hetimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional me agjensitë e specializuara në këtë fushë, si dhe në orjentimin drejt një politike të ashpër dënimi për këto vepra penale.

Në analizë të treguesve statistikore dhe gjendjes së tendencave të këtyre veprave penale, vlerësojmë se është arritur progres në rritjen e efektivitetit dhe forcimit të ligjshmërisë në ndjekjen penale si dhe të ndëshkueshmërisë së autorëve të këtyre veprave.

1. Prokuroria për Krime të Rënda, në vitin 2009, ka ushtruar ndjekje penale për 4 (katër) organizata kriminale, të cilat kanë zhvilluar aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të narkotikëve, rrëmbimit të personit, vrasjes me paramendim dhe vjedhjes me dhunë. Dy prej këtyre organizatave janë referuar nga Policia e Shtetit, ndërsa dy të tjerat nga autoritet gjyqësore të huaja.

Për një procedim penal, me 5 (pesë) të pandehur të arrestuar, janë përfunduar hetimet dhe është ngritur akuzë në gjykatë, ndërsa për tre procedimet e tjera vazhdojnë hetimet në bashkëpunim me autoritet gjyqësore të huaja.

2. Prokuroria për Krime të Rënda, gjithashtu, në vitin 2009, ka ushtruar ndjekje penale për 17 grupe të strukturuar kriminale, të cilat kanë zhvilluar aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të narkotikëve, trafikimit të femrave për prostitucion, vjedhjes, vjedhjes me dhunë, si dhe shkatërrimit të pronës me zjarr. Për 11 grupe kriminale vazhdojnë hetimet në bashkëpunim dhe me autoritet gjyqësore të huaja.

3. Prokuroria për Krime të Rënda, ka ushtruar ndjekje penale, ka ngritur dhe ka përfaqësuar akuzën në gjykim, për 1 (një) procedim penal për veprën penale të fshehjes së fondeve dhe pasurive të tjera që financojnë terrorizmin, neni 230/b i K.Penal. Ky procedim ka përfunduar me deklarimin fajtor dhe dënimin e autorit të këtij krimi. Gjithashtu, Prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës ka në ndjekje penale në hetimet paraprake 1 (një) procedim për veprën penale të nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës, për kryerjen e veprave me qëllime terroriste, neni 232/a K. Penal.

4. Për vepra të trafikimeve të paligjshme, nga analiza e treguesve statistikor, për vitin 2009, të pasqyruara më sipër në raport, evidentohet një tendencë ulje e kriminalitetit të këtyre grup veprash penale. Ky tregues, është rezultat i punës së mirë të bërë nga agjensitë e zbatimit të ligjit si dhe i bashkëpunimit të mirë ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet gjyqësore të huaja. Për këto grup veprash, në vitin 2009, janë ndjekur penalisht 663 procedime, me 250 të pandehur, prej të cilëve për 127 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë. Ka përfunduar gjykimi dhe janë dënuar 160 persona, me tendencë në rritje mbi dy herë.

Gjithësesi në raport me këto tregues, çmujmë se duhen konsideruar edhe indikatorët e huaj për këto grup veprash nga të gjitha agjensitë e specializuara të zbatimit të ligjit të përfshirë në luftën kundër trafikeve.

Krahas trafikimeve, kanë tendencë ulje edhe veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit dhe të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, vepra të cilat janë të lidhura dhe ndikojnë me kryerjen e trafikëve të paligjshme. Vlerësojmë se krahas punës së mirë të policisë kufitare në këtë drejtim, ka sjellë ndikim në parandalimin e tyre dhe ndëshkimi penalisht me dënime të ashpra i autorëve të këtyre veprave.

Në përmbushje të angazhimit për luftën kundër trafikimeve të paligjshme, në Prokurorinë për Krime të Rënda është krijuar një seksion i posaçëm, për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të femrave për prostitucion.

Vlerësojmë se duhet rritur kujdesi nga organet e procedimit për trajtimin e viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore, si në fazën e hetimit ashtu dhe të gjykimit të çështjeve, në funksion të garantimit të të gjithë të drejtave që ato gëzojnë, por edhe për vjeljen e të gjithë të dhënave në shërbim të procesit penal, për ndëshkimin e autorëve.

Në drejtim të trafikimit të mjeteve motorrike, pavarësisht se rezultojnë ende i ulët numri i autorëve që kryejnë këtë kategori veprash penale, në vitin 2009 është bërë një përmirësim i ndjeshëm për riparimin e pasojave civile të këtij aktiviteti kriminal, nëpërmjet kthimit të mjeteve të vjedhura pronarëve të tyre të ligjshëm. Kjo sepse, nga 3-4 raste mjeteve motorrike të kthyer në vitet e mëparshme, në vitin 2009 u janë kthyer pronarëve të ligjshëm 40 të tilla. Vlerësojmë se ky tregues i mirë i punës sonë ka ndikuar dhe do të vazhdojë të ndikojë në uljen e këtij lloji kriminaliteti. Ajo që vlen të theksohet është nevoja për përmirësimin e bashkëpunimit me agjensitë e zbatimit të ligjit, si brenda dhe jashtë vendit, me synim goditjen e këtij fenomeni në nivelin e krimit të organizuar. Në këtë vështrim, vlerësojmë se është i nevojshëm miratimi i propozimit për ndryshimin e nenit 75/a të K.Pr.Penale, duke e kaluar këtë vepër në kompetencë lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda.

Në analizë të treguesve të trafikimit të narkotikëve evidentohet tendencë në ulje, ndërsa në transportimin, mbajtjen dhe shitjen e narkotikëve evidentohet tendencë në rritje nga viti në vit përfshirë këtu edhe vitin 2009. Kjo analizë tërheq vëmendjen për nevojën e një pune më të studiuar, me strategji dhe taktika më të qarta, të orjentuara drejt hetimeve pro aktive, duke synuar goditjen e krerëve të këtij aktiviteti kriminal. Nxitimi për të bërë arrestime në flagrancë të individëve në role fundore në këtë veprimtari, jo rrallë, pengon hetimin e rrjeteve të mirëfillta kriminale që mund të na çojnë në goditjen e autorëve trafikimit të narkotikëve.

Në rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimeve të paligjshme kanë ndikuar përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit dhe kryerja e hetimeve paralele (hetime të njëkohëshme për aktivitet kriminal të zhvilluar në shtete të ndryshme), si dhe format e reja të shkëmbimit të informacionit me autoritetet homologe të huaja, nëpërmjet kontakteve info-operative, të mbështetura në besimin reciprok.

5. Për vepra të korrupsionit, për vitin 2009, nga analiza e treguesve statistikor, evidentohen tregues pothuajse të njëjtë në shifra të koficientit të kriminalitetit, krahasuar me vitin 2008. Nga analiza e këtyre treguesve, evidentohet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në tremujorin e katërt të vitit 2009, periudhë e cila përkon me ngritjen dhe fillimin e funksionimit në Prokurori të 6 (gjashtë) njësive të përbashkëta hetimore kundër korrupsionit dhe krimit financiar. Për këto grup veprash në vitin 2009 janë ndjekur penalisht 129 procedime, me 89 të pandehur, prej të cilëve për 53 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë. Ka përfunduar gjykimi dhe janë dënuar 36 persona, për të tjerët pritet gjykimi i tyre. Personat e hetuar, gjykuar dhe dënuar për këtë grup veprash penale janë funksionar publik të niveleve të ndryshme, nga nëpunës të thjeshtë, të zgjedhur vendor e deri në nëpunës të lartë në institucione qendrore.

Në analizë të secilës prej veprave të korrupsionit, evidentohet tendencë në rritje nga viti në vit i veprave penale të: korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, neni 259 i K. Penal; ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, neni 245/1 i K. Penal dhe korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.

Luftën kundër korrupsionit e kemi konsideruar dhe konsiderojmë si prioritet edhe mbrenda rradhëve të prokurorisë dhe gjyqsorit. Në vitin 2009, është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë për veprën penale të korrupsionit pasiv ndaj një prokurori të shkallës së parë, është ndjekur penalisht për veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm një prokuror i shkallës së parë, dhe është ndjekur penalisht për shpërdorim të detyrës një prokuror i të njëjtit nivel.

Gjithashtu, kemi kërkuar në KLD dhe na është dhënë autorizim për procedim penal ndaj tre gjyqtarëve të shkallës së parë, për veprën penale të korrupsionit pasiv, dy prej të cilëve janë në ndjekje penale në hetimet paraprake, ndërsa për një gjyqtar është ngritur akuzë dhe vendosur dërgimi i çështjes për gjykim.

Në rritjen e numrit të rasteve të procedimeve penale për këto vepra dhe në rritjen e efektivitetit të luftës kundër korrupsionit kanë ndikuar disa faktorë, siç janë: forcimi i bashkëpunimit me institucionet e zbatimit të ligjit dhe rritja e ndjenjës së përgjegjësisë në luftën kundër këtij fenomeni, përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, profilizimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, rritja e besimit të publikut në punën e prokurorisë që evidentohet në rritjen e numrit të rasteve të kallëzuar nga shtetasit për korrupsion.

Një pasqyrë e plotë e këtyre elementëve evidentohet tek njësitë e përbashkëta hetimore kundër korrupsionit dhe krimit financiar të krijuara në vitin 2009. Krijimi i tyre u shpall si prioritet i punës së prokurorisë për vitin 2009 dhe ky angazhim u përmbush me mbështetjen e qeverisë së SHBA-së, nëpërmjet projektit “Marrëveshja e Pragut të Programit të Sfidës së Llogarisë së Mijëvjeçarit në Shqipëri”, faza e dytë. Ngritja e Njësive të Përbashkëta Hetimore pranë Prokurorisë të Rretheve Gjyqësore Shkodër, Vlorë, Durrës, Korçë, Fier, Gjirokastrë dhe vazhdimi i mbështetjes për Njësinë e Përbashkët Hetimore pranë Prokurorisë Tiranë janë sfidat tona.

Akti normativ që ka formalizuar krijimin e këtyre njësive është Memorandumi i Bashkëpunimit, datë 6 Maj 2009, i nënshkruar ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Shërbimit Informativ Shtetëror, KLSH-së dhe ILDKP-së. Në tetor 2009 ka filluar funksionimi i gjashtë njësive të reja, fillimisht vetëm me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë dhe në fillim të vitit 2010 u janë bashkuar këtyre njësive edhe oficerët e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, Tatimeve dhe Doganave. Përzgjedhja dhe emërimi i pjesëtarëve të këtyre njësive është bërë nëpërmjet një procesi serioz veting-u, si në drejtim të aftësive të tyre profesionale ashtu dhe të integritetit.

Nga eksperiencia e deritanishme e njësive është konstatuar nevojë e domosdoshme prezenca pranë tyre e ekspertëve të fushave të ndryshme, veçanërisht e atyre kontabël me cilësinë e këshilltarëve.

Krahas goditjes se fenomenit të korrupsionit kemi vlerësuar si prioritet edhe goditjen e veprave penale në detyrë, neni 248 i K.Penal. Në vitin 2009 janë ndjekur penalisht 665 procedime penale me 228 të pandehur, prej të cilëve është ngritur akuzë në Gjykatë për 180 persona dhe janë dënuar 127 persona. Nga treguesit statistikorë, ndonëse evidentohet tendencë në ulje e referimeve për këtë vepër penale, ka tendencë në rritje të numrit të personave të

akuzuar, dërguar për gjykim dhe të dënuar. Kjo tregon rritje të efektivitetit dhe të ligjshmërisë në ushtrimin e ndjekjes penale dhe ngritjen e akuzës për këtë veprë.

Vlen të theksojmë ushtrimin e ndjekjes penale dhe ngritjen e akuzës në gjyq për këtë veprë në ngarkim të një numri të madh funksionarësh të lartë ushtarakë dhe civilë të Ministrisë së Mbrojtjes, për ngjarjen e Gërdecit, ndaj të cilëve vazhdon gjykimi.

6. Lufta kundër krimit të pastrimit të produkteve të veprës penale ka qenë dhe mbetet prioritet i prokurorisë. Për këtë veprë penale, në vitin 2009 janë ndjekur penalisht 54 procedime, prej të cilëve për 1 (një) të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë, si dhe është dënuar 1 (një) person. Vazhdojnë hetimet për 35 procedime penale, në bashkëpunim me agjensitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe me autoritetet homologe të huaja.

Përmirësimi i bashkëpunimit të Prokurorisë me (FIU) mbetet një angazhim i rëndësishëm i Prokurorisë së Përgjithshme, me synim për të përmbushur detyrat funksionale në luftën e efektshme kundër pastrimit të parave. Në këtë kuadër është caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm pika e kontaktit – një prokuror i Drejtorisë Kundër Krimit të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme – për të bashkërenduar me strukturat e lartpërmendura. Përfaqësuesit e FIU janë në kontakt të përhershëm me njësitë e përbashkëta hetimore duke shkëmbyer informacion të dyanshëm në lidhje me rastet e dyshuara për pastrimin e produkteve të veprës penale. Rezultat i kësaj veprimtarie është fakti se gjatë vitit 2009 ka rritje të ndjeshme të rasteve të referuara nga FIU pranë prokurorisë dhe të hetuara nga ana e prokurorisë për veprat penale të parashikuara nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale”.

II. Problematika që evidentohet nga analiza e treguesve të tendencave të kriminalitetit për disa grup veprash penale dhe/ose vepra të veçanta.

1. Nga një vështrim i përgjithshëm i gjendjes së kriminalitetit dhe grup veprave penale të konsideruara tendencë për vitin 2009 dhe të pasqyruara hollësisht në raport, evidentohet:

1.1. Tendencë në rritje për disa grup veprash penale, dhe/ose për vepra penale të veçanta;

- Grup veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike në përgjithësi janë me tendencë në rritje dhe në mënyrë të veçantë veprat penale të vjedhjes, vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit, vjedhjes me armë, mashtrimit, mashtrimit në sigurime etj. Në tendencën në rritje të këtyre grup veprash penale çojmë se kanë ndikuar faktorë social dhe ekonomik.

- Në grup veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, tërheq vëmendje pesha specifike e lartë, vit pas viti, e veprave penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, si dhe tendenca në rritje e veprave penale të kryera nga drejtuesit e mjeteve, të tilla si largimi nga vendi i aksidentit, drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi. Në tendencën në rritje të këtyre veprave penale kanë ndikuar një sërë faktorësh të tillë si standartet e ulëta në paisjen me leje për drejtim automjeti, mosnjohja dhe neglizhenca në zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor nga të gjithë subjektet, mungesa e sinjalistikës në rrugë dhe mosndëshkimi me ashpërsinë e nevojshme administrativisht dhe penalisht.

- Për veprën penale të organizimit të llotarive të palejuara evidentohet një tendencë në rritje të ndjeshme në dy vitet e fundit. Kjo si rrjedhojë e punës së mirë të bërë nga strukturat e posaçme pranë Ministrisë së Financave, të ngritura për mbikqyrjen e këtij aktiviteti dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

- Për veprën penale të shpërdorimit të tokës evidentohet një tendencë në rritje të ndjeshme në vitin 2009. Kjo gjendje ka ardhur si rrjedhojë e punës së mirë të bërë nga

strukturat e shtetërore për goditjen e ndërtimeve të kryera apo të lejuara në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe jashtë rregjimit juridik të tokës.

1.2. Tendencat në ulje të disa grup veprash penale dhe për vepra penale të

veçanta evidentohen si më poshtë;

- Veprat penale kundër jetës dhe shëndetit në tërësi kanë tendencë në ulje, si pasojë e rritjes së efektit goditës dhe parandalues nga agjensitë e zbatimit të ligjit dhe stabilitetit të sigurisë publike në vend. Brenda këtij grupi veprash evidentohet një tendencë e lehtë rritjeje të vrasjeve me paramendim dhe vrasjeve në rrethana të tjera cilësuese, por me peshë specifike të vogël në këtë grup veprash.
- Për grup veprat penale të falsifikimit të dokumentave në tërësi evidentohet tendencë në ulje. Veçanarisht kjo tendencë konstatohet për veprat penale të falsifikimit të dokumentave, falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave dhe vizave dhe falsifikimit të dokumentave shkollorë. Në këtë tendencë në ulje ka ndikuar, krahas goditjes së këtij fenomeni kriminal edhe rritja e sigurisë së dokumentave zyrtarë dhe prodhimi e futja në qarkullim i kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike.
- Vepra penale e kultivimit të bimëve narkotike evidentohet me tendencë ulje në nivel kombëtar, si rrjedhojë e goditjes dhe parandalimit të kësaj veprimtarie nga agjensitë e zbatimit të ligjit. Megjithatë mbetet ende shqetësuese goditja e kësaj vepre penale në territore të caktuara të vendit.
- Vepra penale e shkeljes së barazisë në tendera apo ankande publike evidentohet me tendencë ulje. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e përmirësimeve ligjore dhe rritjes së transparencës duke aplikuar prokurorimet në rrugë elektronike.
- Vepra penale e ushtrimit të aktivitetit të këmbimit valutor të palicensuar evidentohet me tendencë ulje. Kjo tendencë në ulje ka ardhur si rrjedhojë e goditjes së ashpër të këtij fenomeni, për herë të parë, në vitin 2008, nga strukturat e zbatimit të ligjit.

III. Analizë e disa treguesve në rritje të ndjekjes penale në hetimet paraprake dhe në gjykim

1. Të dhënat statistikore evidentojnë rritje të treguesve cilësorë të hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale në drejtim të forcimit të ligjshmërisë dhe efektivitetit në punën e prokurorëve. Këto tregues konsistojnë në marrjen e personave në cilësinë e të pandehurit, ngritjen e akuzës dhe përfaqësimin e saj në gjykim në emër të shtetit. Në vitin 2007 rreth 69% e personave të pandehur në ndjekje penale në hetimet paraprake janë dërguar për gjykim, kjo shifër për vitet 2008, 2009 është rritur në 74%. Ndërkohë evidentohet rritje e numrit të personave ndaj të cilëve është ngritur akuzë në gjykatë dhe që janë deklaruar fajtorë e dënuar nga gjykata nga rreth 86% në vitin 2007 në rreth 96% në vitet 2008, 2009.

2. Nga analiza e treguesve statistikore evidentohet se organi i Prokurorisë ka qënë i orientuar drejt një politike të ashpër dënimi në kërkesat që janë paraqitur në gjykatë për dënimin e autorëve të veprave penale. Kjo politikë e ashpër dënimi spikat veçanarisht ndaj autorëve të veprave penale që rezultojnë me tendencë në rritje, si dhe ndaj autorëve të veprave penale që janë konsideruar prioritet i punës së organit të akuzës. Qëllimi i zbatimit të kësaj politike penale ka qënë jo vetëm ndëshkimi i autorëve të veprave penale, por edhe dhënia e një efekti parandalues. Nga krahasimi i të dhënave statistikore evidentohet se përgjithësisht gjykatat e të gjitha niveleve kanë aplikuar lloje dhe masa më të buta dënimi se ato të kërkuara nga prokurorët.

3. Analiza e treguesve të ndjekjes penale në hetimet paraprake dhe të procedimeve penale të përfunduara për vitin 2009, evidenton tendencë në rritje të procedimeve të

pezulluara për moszbulim të autorit në shifrën 1261 procedime. Kjo tendencë rritje evidentohet vit pas viti. Në analizë të treguesve statistikor rezulton se 72 % e procedimeve penale të pezulluara i përkasin veprës penale të vjedhjes së pasurisë. Kjo gjendje evidenton mangësi në zbulimin e autorëve nga strukturat përkatëse të shërbimeve të policisë së shtetit, si dhe nevojën për përmirësimin rrënjësor të punës nëpërmjet hartimit të një strategjie për të luftuar këtë fenomen në të gjithë dimensionet e tij.

PJESA E KATËRT

IV. REFORMIMI I PROKURORISË, RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE ME MISIONET NDËRKOMBËTARE

I. Reformimi i Prokurorisë

Në përmbushje të detyrimeve të saj kushtetuese dhe ligjore për ushtrimin me efikasitet të funksioneve të ngarkuara me ligj, prokuroria shqiptare krahas punës së saj të përditshme në ushtrimin e ndjekjes penale është angazhuar seriozisht dhe në përmirësimin e treguesve të tjerë të cilët në mënyrë integrale janë pjesë e funksioneve të saj kushtetuese. Në këtë kontekst kemi konsideruar reformimin e brendshëm si një element vital për mirëfunksionimin e institucionit. Në funksion të këtij qëllimi, duke shfrytëzuar asistencën e partnerëve ndërkombëtarë dhe misionëve të huaja që asistojnë e mbështesin punën e prokurorisë, në vitin 2009 janë përgatitur një sërë aktesh normative të cilat janë të drejtuara drejt vendosjes së rregullave për funksionimin e brendshëm të institucionit dhe rritjes së transparencës në aktivitetin e tij. Përgatitja e akteve është bërë duke u mbështetur në ligjin organik të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë dhe në rekomandimin nr. 19/2000 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

1. Gjatë këtij viti janë përgatitur dhe një sërë aktesh normative të Prokurorit të Përgjithshëm si:

- Rregullorja e brendshme e funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila synon të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e sejcilës hallkë të institucionit, të formalizojë marrëdhëniet dhe mënyrat e komunikimit të këtyre hallkëve me qëllim individualizimin e funksioneve dhe përgjegjësi
- Rregullorja për “Trajnimin e prokurorëve” e cila synon trajnimin dhe specializimin e tyre në drejtime të caktuara, në përputhje me nevojat e hetimeve, si dhe në reflektim të rekomandimeve të partnerëve të huaj që na asistojnë në punën tonë;
- Rregullorja e inspektimit dhe e procedimit disiplinor të prokurorëve, e cila synon të rrisë transparencën dhe të garantojë të drejtat e prokurorëve që do të inspektohen dhe do të procedohen disiplinarisht.
- Rregullorja e Këshillit të Prokurorisë, e cila do të përmirësojë në të ardhmen punën e këtij organi të rëndësishëm këshillimor pranë Prokurorit të Përgjithshëm.
- Rregullorja për sistemin e vlerësimit të prokurorëve, e cila do të japë një impakt të ri punës së tyre. Vlerësimi i punës së prokurorëve, do të shërbejë si kriter bazë për emërimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve, me synim implementimin e kuadrit ligjor në përfaqje me standartet europiane.
- Janë miratuar një sërë urdhërash nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm si:
 - Urdhëri “Për ushtrimin me efikasitet të së drejtës së ankimit”, i cili ka synuar dhe ka ndikuar në unifikimin e punës së prokurorëve të gjithë nivele në ushtrimin e të drejtës së ankimit nga prokurorët.
 - Urdhëri për përcaktimin e kriterëve të shpërblimit të prokurorëve, akt i cili synon trajtimin me shpërblim të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore mbi kriteret meritokracie;
 - Urdhëri për mbledhjen e prokurorëve, që synon identifikimin e problematikave në punën e prokurorëve të prokurorisë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe pranë

Gjykatave të Apeleve dhe tërheqjen e mendimit të prokurorëve në lidhje me këto problematika dhe nevojave për unifikimin e qëndrimeve;

2. Forcimi i kontrollit të brendshëm.

Funksion i rëndësishëm i punës së strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme ka qenë dhe mbetet kontrolli i brendshëm i prokurorëve të shkallës së parë dhe atyre të apeleve me synim mbikqyrjen e ushtrimit të funksioneve prej tyre në zbatim të kushtetutës, ligjit dhe akteve normative të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në përmbushje të këtij funksioni, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2009 kanë ushtruar kontrole të përgjithshme, të pjesëshme, për grup çështjesh dhe për çështje të veçanta.

Kështu, janë ushtruar kontrole në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Kurbin, Sarandë, Berat, Kukës, si dhe në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

Në konkluzion të kontrolleve, për shkeljet ligjore të evidentuara në aktet procedurale në hetimet paraprake të prokurorëve, rast pas rasti është vendosur shfuqizimi i tyre, si dhe është filluar procedimi disiplinor, deri dhe penal ndaj prokurorëve.

Më konkretisht janë proceduar disiplinarisht 13 prokurorë, nga të cilët 6 janë shkarkuar, 2 janë ulur në detyrë dhe 4 me vërejtje dhe 1 është në proces.

II. Forcimi i kapaciteteve në organin e prokurorisë.

Forcimi i kapaciteteve në prokurori ka qenë dhe mbetet një nga objektivat e punës sonë me synim rritjen e aftësive profesionale dhe profilizimin e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës për të rritur efektivitetin në ushtrimin e funksioneve ligjore.

Në mënyrë të veçantë ky proces është fokusuar në trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore pjesëtarë të njësisë të përbashkëta hetimore duke shfrytëzuar maksimalisht mbështetjen dhe asistencën e dhënë nga OPDAT-i për këtë qëllim. Tematika e këtyre trajnimeve ka qenë fokusuar në përdorimin e metodave të specializuara të hetimit të krimit financiar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, nëpërmjet këtyre trajnimeve është tentuar të bëhet një zberthim teorik i dispozitave të reja procedurale dhe materiale penale në këtë fushë, i harmonizuar me diskutimin e rasteve konkrete praktike. Këto trajnime të zhvilluara brënda dhe jashtë vendit, kanë rezultuar të efektshme edhe për shkak të përcjelljes së praktikave më të mira të vendeve me një eksperiencë të gjatë dhe të konsoliduar në drejtim të luftës kundër këtij lloji kriminaliteti.

Në proces të vazhdueshëm trajnimi, të zhvilluara kryesisht jashtë vendit, kanë qenë edhe prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë për Krime të Rënda. Këto trajnime janë fokusuar kryesisht në diskutimin e problematikave që lidhen me goditjen e krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Në proces trajnimi kanë qenë të gjithë prokurorët e republikës në kuadër të trajnimit vazhdueshëm të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, tematika e të cilës ka qenë e zgjedhur nga vetë prokurorët.

Në proces trajnimi kanë qenë edhe punonjësit e administratës së sistemit të prokurorisë, fokusuar në menaxhimin e fondeve buxhetore i mbështetur nga misioni EURALIUS.

Nisur nga rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë, jemi orientuar dhe janë zhvilluar trajnime të përbashkëta me prokurorët dhe shërbimet e policisë gjyqësore të policisë së shtetit. Me qëllim përmirësimit dhe shpalosjen e politikave të përbashkëta gjatë zhvillimit të këtyre

trajtimeve, është finalizuar së fundmi një udhëzim i përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrin e Brendshëm.

III. Marrëdhëniet e Prokurorisë me institucionet e tjera

Në zbatim të kushtetutës dhe ligjit, për përmbushjen e misionit të saj, Prokuroria ka ndërtuar marrëdhënie me të gjitha institucionet dhe hallkat e pushteteve.

1. Marrëdhëniet me institucionin e Presidentit të Republikës, kanë qenë dhe janë institucionale, në mbështetje të reformës në organin e prokurorisë dhe të veprimtarisë së saj. Në vitin 2009, Presidenti i Republikës ka dekretuar emërimet në detyrë të prokurorëve të rinj, transferimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve, në përgjigje të propozimeve të dërguara nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjithashtu, institucioni i Presidentit të Republikës është informuar në vazhdimësi për konkluzionet e kontrolleve të ushtruara në organin e prokurorisë dhe problematikat e konstatuara në funksionimin e sistemit të drejtësisë.

2. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë janë të ndërtuara në linja institucionale dhe korrekte. Prokuroria është thirrur dhe ka shfaqur mendimin e saj në Komisionet respektive kur janë diskutuar amendime të ligjeve të cilët janë pjesë e punës së prokurorisë. E kemi vlerësuar këtë formë komunikimi si pozitive dhe të efektshme, për sa kohë një pjesë e mendimeve të shfaqura prej nesh janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në amendimet që kanë qenë në diskutim e sipër.

Gjithësesi, sjellim në vëmendje tuaj dhe kërkojmë mbështetjen e Kuvendit në drejtim të:

- Rritjes së fondeve buxhetore dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve duke i trajtuar ato si nevojë e institucionit për ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese dhe për implementimin e ndryshimeve që pësoi ligji organik i prokurorisë.
- Amendimeve të nevojshme ligjore me qëllim kufizimin e imuniteteve për ti hapur rrugë organit të akuzës që të ushtrojë më me efektivitet ndjekjen penale edhe për këtë kategori personash, veçanërisht në drejtim të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve në detyrë.
- Amendimeve të nevojshme ligjore me qëllim dhënien e së drejtës Prokurorit të Përgjithshëm për të vënë në lëvizje kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë me synim unifikimin e praktikave gjyqësore, si dhe të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që janë në juridiksionin e kësaj Gjykate.

3. Në marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave Prokuroria ka orientuar punën e saj duke ndjekur në dinamikë prioritetet e qeverisë për luftën ndaj kriminalitetit. Aspekte të tjera të marrëdhënieve me Këshillin e Ministrave janë:

- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të prokurorisë në Komitetet Ndër-institucionale të ngritura nga qeveria.
- Angazhimi i përfaqësuesve të prokurorisë në kuadrin e proceseve integruese të Shqipërisë në BE, nëpërmjet plotësimin të pyetësorit të KE-së dhe procesin e liberalizimit të vizave në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Integritetit etj.
- Përgatitja e një memorandumi bashkëpunimi me Departamentin Antikorrupsion të KM, në kuadrin e rekomandimeve të GRECO-s;

4. Marrëdhëniet me Ministrinë e Brendshme janë karakterizuar nga fryma e bashkëpunimit të ndërsjellë për zbatimin e ligjit dhe akteve normative të përbashkëta. Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe shërbimet e policisë gjyqësore në varësi të saj, vlerësohet si shumë i rëndësishëm në efektivitetin e punës së organit të prokurorisë dhe në

mënyrë të veçantë në cilësinë e hetimit. Në funksion të këtij bashkëpunimi është nxjerrë Urdhëri i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrin e Brendshëm, datë 15.04.2008.

Vlen të përmenden si një eksperiencë pozitive për vitin që kaloi bërja e analizave të përbashkëta të cilat kanë shoqëruar hetimet paraprake. Këto analiza janë bërë si në nivelin e bazës ashtu edhe në nivel qendror në raste të veçanta apo për vepra penale të konsideruara prioritet.

Krahas arritjeve, në marrëdhëniet me shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit, kemi evidentuar dhe ndarë me krerët e institucionit shqetësimet lidhur me nivelin profesional dhe paqëndrueshmërinë në detyrë të oficerëve të shërbimeve të policisë, faktorë të cilët kanë ndikuar qoftë në cilësinë ashtu dhe në mbarëvajtjen e hetimeve.

Duke qenë pjesë e grupit të punës për amendimet në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, kemi prezantuar aty idetë tona për këto ndryshime duke reflektuar si për eksperiencat pozitive, ashtu dhe problematikat e cituara më lart.

Në këtë kuadër, pjesë shumë të rëndësishme konsiderojmë vazhdimin e mënyrës së organizimit të strukturave të Policisë Gjyqësore duke u bazuar në përvojën pozitive të krijuar derimë tani, duke ndërhyrë për të përmirësuar mangësi që mund të jenë vënë re gjatë periudhës dhjetë vjeçare të hyrjes në fuqi dhe të zbatimit të ligjit organik “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

5. Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë për shkak të parashikimeve ligjore janë të orientuara në disa drejtime, të cilat ndërtohen kryesisht në rekomandimet për prioritet e luftës kundër kriminalitetit, që Ministria i paraqet në prokurori në emër të Këshillit të Ministrave. Megjithë mungesën e paraqitjes së tyre për vitin 2009 raportet me Ministrinë e Drejtësisë janë ndërtuar mbi baza ligjshmërie dhe bashkëpunimi institucional, si më poshtë:

- Në inspektimet që Ministria e Drejtësisë ka kryer në institucionin e prokurorisë. Ministria e Drejtësisë në vitin 2009, ka sjellë në Prokurorinë e Përgjithshme raportin e kontrollit të bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë vitit 2008. Nga raporti i paraqitur rezulton se inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë kanë kontrolluar në këtë prokurori 4982 fashikuj (vendime mosfillimi dhe pushime të procedimit penal). Nga ky volum, prej inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë është kontestuar zgjidhja e dhënë nga prokurorët në 280 vendime mosfillimi dhe vendime pushimi procedimi penal, që zënë 5.6% të tyre. Nga prokurorët e Drejtorisë së Inspektimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme janë shqyrtuar konkluzionet e Ministrisë së Drejtësisë duke ushtruar kontroll të drejtpërdrejtë për të gjitha dosjet e kontestuara. Në përfundim të këtij kontrolli është konkluduar për shfuqizimin e 47 vendimeve.

Gjithashtu, gjatë vitit 2009 Ministria e Drejtësisë ka ushtruar kontroll tematik për çështje të veçanta në 21 prokurori të rretheve gjyqësore për një total prej 134 çështje. Në përfundim të këtyre kontrolleve, Ministria e Drejtësisë ka kontestuar zgjidhjet e çështjeve nga prokurorët vetëm në 7 çështjeve ose rreth 5 % të tyre. Nga prokurorët e Drejtorisë së Inspektimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme janë shqyrtuar konkluzionet e Ministrisë së Drejtësisë duke ushtruar kontroll të drejtpërdrejtë për të gjitha dosjet e kontestuara. Në përfundim të këtij kontrolli është konkluduar për shfuqizimin e 1 (një) vendimi.

- Në drejtim të pjesëmarrjes në përbërje të grupeve të punës gjatë procesit të hartimit të legjislacionit, vlen për t’u theksuar përvoja pozitive e bashkëpunimit me strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë kuadër përmendim pjesëmarrjen si më poshtë:

Grupi i punës për përmirësimin e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”;

Grupi i punës për hartimin e projektligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”;

Grupi i punës për hartimin e projektligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”

Dhënia e mendimeve për përditësimin e strategjisë ndërsektoriale në fushën e drejtësisë.

▪ Një drejtim tjetër i rëndësishëm i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë është në fushën marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale.

6. Marrëdhëniet me Shërbimin Informativ Shtetëror janë të fokusuar kryesisht në marrjen e informacionit nga ky shërbim në funksion të rritjes së efektivitetit në ndjekjen penale, veçanërisht në kuadër të veprave penale të krimit të organizuar dhe terrorizmit, trafikeve të paligjshme dhe korrupsionit. Informacionet e përcjella nga SHISH kanë rezultuar të vlefshme dhe na kanë orientuar drejt në nisjen e procedimeve penale.

7. Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Drejtësisë konsiderohen pozitive dhe në vitin 2009 janë pasqyruar në procesin e dhënies së autorizimit për procedim penal ndaj gjyqtarëve për të gjitha rastet e kërkuara nga ana jonë. Gjithashtu kemi shkëmbyer informacion për rastet e shkeljeve në detyrë të gjyqtarëve.

8. Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive janë ndërtuar bazuar në ligj dhe në memorandumet e bashkëpunimit me secilin prej tyre. Ne i kemi konsideruar dhe i konsiderojmë këto institucione si burim i rëndësishëm dhe i vlefshëm për referimin e grup veprave penale që lidhen me korrupsionin, krimin në detyrë dhe krimin financiar. Për shkak të kësaj rëndësia të dy këto institucione janë ftuar të jenë pjesë e Njësisë të Përbashkëta Hetimore nëpërmjet nënshkrimit të Memorandumit, datë 6 maj 2009, për krijimin e këtyre njësisë. Bashkëpunimi në kuadër të këtij memorandumi tashmë zhvillohet në terma konkret dhe shumë më fleksibël, nëpërmjet pikave të kontaktit të këtyre institucioneve në Njësitë e Përbashkëta Hetimore.

Nga të dhënat statistikore, për vitin 2009, evidentohet tendencë në ulje e kallzimeve të referuara nga secili prej tyre në organet e prokurorisë. Konkretisht, në vitin 2009, KLSH-ja, ka paraqitur në prokurori 10 kallzime penale nga 32 kallzime të paraqitura në vitin 2008, ndërsa ILDKP-ja ka paraqitur 13 kallzime penale nga 23 të paraqitura një vit më parë. Këto kallzime penale të ardhura nga këto dy institucione janë trajtuar me seriozitetin e duhur, dhe një pjesë prej tyre i është dhënë zgjidhja ligjore, ndërsa për pjesën tjetër vazhdojnë hetimet paraprake.

9. Prokuroria ka patur dhe ka korrespondencë të vazhdueshme me institucionin e Avokatit të Popullit. Gjatë vitit 2009, janë vlerësuar dhe ndjekur me seriozitet në 5 raste rekomandimet e paraqitura nga ky institucion, nëpërmjet verifikimit të pretendimeve të ngritura, përmes verifikimit të bazës dokumentare dhe marrjes kontakt me personat të evidentuar përgjegjës për shkeljet e pretenduara. Ky proces, rast pas rasti, është shoqëruar me ndërhyrje në organet përkatëse për të rivendosur të drejtën e shkelur dhe parandaluar përsëritjen e rasteve të tjera të ngjashme. Në përgjigje të rekomandimeve të këtij institucioni, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerr një qarkore “Mbi trajtimin e të miturve në organet e policisë, në procesin e zbatimit të masave të ndalimit dhe arrestit”, e cila i është dërguar për zbatim prokurorive të të gjitha niveleve.

10. Kujdes kemi bërë dhe do të bëjmë edhe në të ardhmen në marrëdhëniet e prokurorëve me sistemin gjyqësor. Në këtë drejtim, në punën tonë kemi synuar të respektojmë me rigorozitet pavarësinë dhe paanësinë e gjykatave, në veçanti duke mos hedhur dyshime mbi vendimet gjyqësore dhe as të vonojnë ekzekutimin e tyre, përveç rastit kur ushtrohet e drejta e

apelit ose kur kërkohen shpjegime të tjera procedurale. Kemi synuar dhe synojmë që prokurorët të jenë profesional, objektive dhe të ndershëm gjatë procedurave gjyqësore, veçanërisht duke siguruar që gjykatës t'i jenë paraqitur të gjitha faktet që kanë lidhje me akuzën e ngritur dhe argumentat ligjore të nevojshëm për administrimin e duhur të drejtësisë.

Në të gjithë këtë raport me sistemin gjyqësor mbajmë në konsideratë faktin se Prokuroria ka për detyrë të ngrejë akuzë në emër të shtetit dhe përgjigjet për efektivitetin e luftës kundër kriminalitetit, ndërsa gjykata duhet të japë drejtësi pas zhvillimit të një procesi gjyqësor të drejtë.

IV. Marrëdhëniet me misionet ndërkombëtare

Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit të kaluar ka qënë e përfshirë në disa projekte të financuara nga strukturat e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Qeverisë së SHBA e donatorve të tjerë. Ajo që duhet thënë është se këto projekte kanë patur një impakt shumë pozitiv në punën e prokurorisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal ndërmjet prokurorive një kontribut të rëndësishëm ka dhënë projekti PROSECO, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Kemi sot një rritje të dukshme të rasteve të bashkëpunimit ndërmjet prokurorive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, gjë e cila ka kontribuar dukshëm në rritjen e efikasitetit të punës në luftë kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të ndryshme. Firmosja në fillim të këtij viti në Romë e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorëve të Përgjithshëm të Ballkanit Perëndimor është një arritje e suksesshme e këtij projekti.

Gjatë vitit 2009 u implementua projekti i binjakëzimit të Prokurorisë Shqiptare me Prokurorinë e Përgjithshme të Spanjës dhe Këshillin e Lartë të Magjistraturës së Italisë, i financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt realizoi me shumë sukses objektivat e parashikuara në drejtim të përgatitjes së akteve për vlerësimin e punës së prokurorëve, përgatitjes së disa protokolleve për hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit financiar dhe për krimet që lidhen me mjedisin.

Projekti i Binjakëzimit me Zyrën Kriminale Federale Gjermane me objekt "Lufta kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar", i financuar nga Bashkimi Evropian I përfunduar në vitin 2009, ka dhënë një kontribut të suksesshëm në luftën kundër krimit financiar dhe pastrimit të parave.

Prokuroria është një nga përfituesit të projektit të Sfidës së Mijëvjeçarit Faza e 2-të, e financuar nga Qeveria e SHBA. Objekt i këtij projekti ka qënë dhe është mbështetja për ngritjen dhe funksionimin e njësive të përbashkëta hetimore.

Prokuroria e Përgjithshme është përfituese gjithashtu dhe nga tre projekte të financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit IPA.

Prokuroria Shqiptare do të përfitojë së shpejti nga financimet e Komisionit Europian për informatizimin e sistemit të Prokurorisë, "CSM".

Ky sistem vlerësohet si shumë i rëndësishëm në drejtim të efektivitetit të punës së Prokurorisë, në drejtim të transparencës, në drejtim të kontrollit të punës së organit në tërësi, por edhe të çdo Prokurorie në veçanti. Gjithashtu, do të bëjë të mundur krijimin e një baze të dhënash për të analizuar me hollësi tendencat e kriminalitetit në vend.

Në një të ardhme do të arrihet komunikimi on-line, jo vetëm brenda për brenda sistemit të Prokurorisë, por edhe me agjensitë e tjera të zbatimit të ligjit.

Projekti “Mbështetje për strukturat e hetimit të krimit financiar dhe pastrimit të parave”. Përfitues kryesor i këtij projekti është Prokuroria e Përgjithshme dhe përfitues të tjerë janë Ministria e Brendshme (Drejtoria e Hetimit të Krimit Ekonomik në Policinë e Shtetit) dhe Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Aseteve të Konfiskuara).

Objekti është të rritet kapacitet e hetimit të veprës penale të pastrimit të parave dhe krimit financiar, duke forcuar bashkëpunimin institucional ndërmjet strukturave të zbatimit të ligjit.

Projekti kundër korrupsionit në Shqipëri “PACA“, me objektiv të përgjithshëm “Dhënien e kontributit për demokracinë dhe shtetin e të drejtës nëpërmjet parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit”. Në këtë projekt Prokuroria e Përgjithshme është një nga përfituesit e tij, bashkë me insitucione të tjera që merren me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në Shqipëri.

Një moment tjetër që dua të theksoj është fakti që duhet të përfshihen në këto projekte më shumë pjestarë të sistemit gjyqësor, pra gjyqtarë të niveleve të ndryshme.

PJESA E PESTË

PRIORITETET E PROKURORISË PËR VITIN 2010

Në përcaktimin e prioriteteve për vitin 2010, jemi mbështetur në prioritetet e shpallura nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, në strategjitë kombëtare të miratuara, në progres raportin dhe në rekomandimet që vijnë nga partnerët e huaj për shkak të angazhimeve të shtetit shqiptar në organizmat ndërkombëtare, si dhe në problematikat e punës së organit të prokurorisë dhe tendencat e kriminalitetit të evidentuara gjatë vitit 2009.

1. Bashkëpunimi ndër-institucional me Policinë Gjyqësore vlerësohet si shumë i rëndësishëm në efektivitetin e punës së organit të prokurorisë. Për këtë qëllim, do të vazhdojë angazhimi i përfaqësuesve të prokurorisë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, me synim përmirësimin e funksionimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit.

2. Bashkëpunimi ndër-institucional me Ministrinë e Drejtësisë vlerësohet, gjithashtu, aspekt i rëndësishëm që ndikon në rritjen e efektivitetit të punës së organit të prokurorisë. Për këtë qëllim, do të vazhdojë angazhimi i përfaqësuesve të prokurorisë në hartimin e projekt akteve ligjore për të cilat do të çmohet e nevojshme dhënia e mendimit tonë. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, për vitin në vazhdimi do të synojmë hartimin e një memorandumi të përbashkët për koordinimin e punës në kryerjen e inspektimeve në prokurori nga Drejtoria e Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë dhe nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu, do të synojmë institucionalizimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përkatëse në dy institucionet për përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë.

3. Lufta kundër korrupsionit ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet e punës së prokurorisë. Në funksion të këtij prioriteti, me synim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, si dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në hetimin dhe ndjekjen penale kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, do të vazhdojë të mbështetet në të gjitha drejtimet puna e 7-të njësive të përbashkëta të ngritura për këtë qëllim.

4. Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikëve të paligjshme dhe pastrimit të parave do të vazhdojë të jetë prioritet i punës sonë. Për realizimin e këtij prioriteti do të fokusohemi kryesisht:

- Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e zbatimit të ligjit brënda vendit, duke i dhënë rrugë kryesisht hetimeve proaktive për goditjen e këtij lloj kriminaliteti.
- Zbatimin me efikasitetin e duhur të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” të ndryshuar.
- Zbatimin me efikasitet të ligjit të ri “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.
- Shfrytëzimin në maksimum të të gjithë materjalit informative që vjen nga agjensitë e ndryshme të shërbimeve inteligjente.
- Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e huaja të zbatimit të ligjit, duke tentuar të përdorim sa më shumë hetime paralele dhe të rrisim fleksibilitetin në shkëmbimin e informacionit.
- Në vazhdimin e trajnimeve për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin e ndryshime të reja ligjore dhe për përmirësimin e përdorimit më me efektivitet të metodave të posaçme të hetimit.

5. Lufta kundër veprave penale të vjedhjes së pasurisë me tendencë në rritje në vitin e kaluar do të jetë prioritet i prokurorisë për sa kohë ajo konsiderohet e lidhur ngushtë me sigurinë publike, duke :

- Forcuar kontrollin periodik të procedimeve penale në ndjekje dhe atyre të pezulluara për këto vepra penale.
- Ashpërsimin e politikës penale në drejtim të autorëve të këtyre veprave penale.

6. Lufta kundër veprave penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor me tendencë në rritje në vitin e kaluar do të jetë prioritet i prokurorisë për sa kohë ajo konsiderohet e lidhur ngushtë me mbrojtjen në mënyrë të posaçme legjislacioni shqiptar i bën jetës dhe shëndetit të shtetasve duke :

- Orientuar rritjen e pranisë së prokurorit në vendngjarje me pasoja të rënda.
- Rritjen e cilësisë së veprimeve të para hetimore.
- Ashpërsimin e politikës penale në drejtim të autorëve të këtyre veprave penale.

7. Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore mbetet prioritet edhe për vitin në vazhdim. Në këtë kuadër vëmendje do ti kushtohet:

- Rritjes së transparencës në emërimin dhe promovimin e prokurorëve.
- Rritjes së transparencës në procesin e inspektimit dhe procedimit disiplinor të prokurorëve.
- Rritjen e nivelit profesional nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe të specializuara të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.
- Efikasitetit të sistemit të vlerësimit të prokurorëve.
- Rritjes së integritetit të prokurorit duke synuar përmirësimin e motivimit për shpërblimet financiare.
- Shfrytëzimit maksimal të gjithë produktit të përfituar nga projektet e huaja në mbështetje të Prokurorisë së Përgjithshme.
- Rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve të Qendrës së Përgjimit.
- Përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore për përmirësimin e kushteve dhe ambjentëve të punës për prokurorët, veçanërisht në zyrat ku janë ngritur Njësitë e Përbashkëta Hetimore.

Ky raport jep sinjale pozitive dhe kurajoje për vendin tonë drejt rrugës së garantimit të sigurisë, prosperitetit dhe stabilitetit.

Sfida të mëdha kemi ende përpara, përderisa reforma në drejtësi është ende në qendër të vëmendjes. Bazuar në tendencat e vëna në dukje në këtë raport, është e qartë se punë mjaft e mirë është bërë deri tani, por probleme ende ka dhe do të jenë në fokusin e punës tonë.

Ju siguroj se Prokuroria në të gjitha hallkat e saj do të realizojë prioritetet në luftë kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimin të organizuar, korrupsionit në veçanti duke rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit si dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kemi synuar dhe do të synojmë ta ngrejmë drejtësinë shqiptare drejt standarteve që i kemi aspiruar prej kohësh duke u përpjekur me gjithçka tonën të mirë, që t'i kthejmë vlerat këtij sistemi kaq të rëndësishëm sepse, për ne drejtësia është kurorëzimi i lavdishëm i virtytit.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Ina RAMA

PËRMBAJTJA

H Y R J E	1
VOLUMI I PUNËS SË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2009	2
MBI PROCEDIMET E HETUARA DHE TË PËRFUNDUARA.....	5
MOSFILLIMET	7
PROCEDIME PENALE TË RREGJISTRUARA SIPAS RRETHEVE DHE KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT	8
KOEFIÇIENTËT E KRIMINALITETIT.....	14
TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT PËR VITIN 2009.....	16
TË DHËNA NË LIDHJE ME REFERIMET	17
VEPRAT PENALE KUNDËR PËRSONIT, KRIME KUNDËR JETËS.....	18
TE PANDEHURIT	19
TENDENCA	20
NENI 78, “VRASJA ME PARAMENDIM”, I KODIT PENAL.....	22
NENI 79 I KODIT PENAL “VRASJA NË RRETHANA TË TJERA CILËSUESE”	26
NENI 84 I KODIT PENAL “KANOSJA”	28
NE LIDHJE ME VEPRËN PENALE TË VRASJES NGA PAKUJDESIA (NENI 85)	31
TE PANDEHURIT	33
VEPRAT PENALE TË KRYERA ME DASHJE KUNDËR SHËNDETIT	34
TE PANDEHURIT	35
TENDENCA	36
VEPRAT PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	42
TË PANDEHURIT	42
VEPRAT PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS”	44
TE PANDEHURIT	45
TENDENCA	46
“KRIME SEKSUALE”	51
TË PANDEHURIT	53
TENDENCA	54
VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME TRAFIQET E PALIGJSHME.....	56
TË PANDEHURIT	57
TENDENCA	58
VEPRAT PENALE PRODHIM TE NARKOTIKEVE, KULTIVIMIT DHE SHITJES SE TYRE	66
TË PANDEHURIT	67
TENDENCA	68
VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË PËRSONIT	72
TË PANDEHURIT	73
TENDENCA	74
VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME SHFRYTËZIMIN DHE USHTRIMIN E PROSTITUCIONIT	78
TË PANDEHURIT	79
TENDENCA	80

PËR VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT	85
TË PANDEHURIT	86
TENDENCA	87
VEPRA PENALE NË LIDHJE ME DETYRËN	91
TË PANDEHURIT	93
TENDENCA	94
PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE	101
TË PANDEHURIT	102
TENDENCA	103
PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME ORGANIZATAT DHE GRUPET E STRUKTURUARA KRIMINALE	104
TË PANDEHURIT	105
TENDENCA	106
VEPRA PENALE QË LIDHEN ME VJEDHJEN E PASURISË	107
TË PANDEHURIT	108
TENDENCA	109
PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME MASHTRIMET	119
TË PANDEHURIT	121
TENDENCA	122
VEPRA PENALE QË KANË TË BËJNË MË SHKATËRRIMIN E PRONËS	125
TË PANDEHURIT	127
TENDENCA	128
PËR VEPRAT PENALE NË LIDHJE M E SHOQËRITË TREGTARE.....	133
TË PANDEHURIT	134
TENDENCA	135
PËR VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE.....	136
TË PANDEHURIT	137
TENDENCA	138
VEPRAT PENALE NE LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET.....	144
TË PANDEHURIT	145
TENDENCA	146
PËR VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME FALSIFIKIMIN E MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË.....	147
TË PANDEHURIT	148
TENDENCA	149
PËR VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME FALSIFIKIMIN E DOKUMENTEVE	151
TË PANDEHURIT	152
TENDENCA	153
MBI VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME ZHVILLIMIN E PALEJUAR TE LOJËRAVE TË FATIT.....	161
TË PANDEHURIT	162
TENDENCA	163
PËR VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË.....	165
TË PANDEHURIT	168
TENDENCA	169
TENDENCA	170
VEPRA PENALE NË LIDHJE ME QËLLIME TERRORISTE.....	175
VEPRA PENALE QE CENOJNË REGJIMIN JURIDIK TE TOKES	175
TË PANDEHURIT	175
TENDENCA	176

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT	178
TË PANDEHURIT	179
TENDENCA	180
PËR VEPRA PENALE QË LIDHEN ME KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT	182
TË PANDEHURIT	184
TENDENCA	185
VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES DHE SIGURISË PUBLIKE	188
TË PANDEHURIT	192
TENDENCA	193
VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHTETËRORE.....	206
TË PANDEHURIT	207
TENDENCA	208
TË DHËNAT PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2009.....	213
GJINIA E TË PANDEHURVE.....	215
TË PANDEHUR TË MITUR.	216
NË LIDHJE ME DINAMIKËN E VEPRAVE PENALE TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR.8003, DATË 28.9.1995(I NDRYSHUAR) “KODI PENAL USHTARAK”	221
TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KERKUARA NGA PROKURORËT	221
TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2009.....	226
ANALIZË E GRUP TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË	229
IV.REFORMIMI I PROKURORISË, RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE ME MISIONET NDËRKOMBËTARE	235
PJESA E PESTË	242
PRIORITETET E PROKURORISË PËR VITIN 2010	242